

NË TOKËN AMË

Kosovë



Përvajtja

8

PRISHTINA

Parku i Gërmisë 10
Teatri Kombëtar i Kosovës 14
Qendra për Rini dhe Sport 16
Biblioteka Kombëtare 20
Xhamia e Jashar Pashës 24
Muzeu Kombëtar i Kosovës 28
Hyjnesha në Fron 34
Muzeu Etnologjik i Kosovës 36
Hamami i Prishtinës 42
Sahat Kulla 44
Katedralja "Nënë Tereza" 46
Gollaku 48
Qyteti Antik i Ulpijanës 50
Liçeni i Badovcit 54
Fshati Marec 58
Parku i Blinajës 62
Janjeva 65
Shpella e Gadimës 68
Liçeni i Batllavës 72
Lumi i Llapit 76
Liçeni i Vasilevës 78
Kalaja e Vuçakut 80
Guri i Plakës 82

86

MITROVICA

Monumenti i Mitrovicës 88
Liçeni i Mitrovicës 90
Muzeu i Qytetit 94
Hamami i Mitrovicës 98
Manastiri i Sokolicës 100
Miniera e Trepçës 102
Muzeu i Kristaleve të Kosovës "Trepça" 104
Ujëvara e Trepçës 108
Kalaja e Zveçanit 110
Kulla e Isa Boletinit 112
Liçeni i Ujmanit 116
Shala e Bajgorës 118
Kalaja e Vushtrrisë 124
Ura e Gurit 128
Hamami i Gazi Ali Beut 132
Kompleksi Memorial "Adem Jashari" 134

140

PEJA

Çarshia e Vjetër e Qytetit 142
Hamami i Haxhi Beut 144
Muzeu i Pejës 146
Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës 150
Parku i Karagaçit 154
Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna 156
Liçeni i Kuqishtës 158
Liçeni i Zembrës 164
Parku Nacional i Rugovës 168
Via Ferrata në Pejë 182
Drini i Bardhë 184
Shpella e Radavcit 188
Burimi i Istogut 190
Bjeshkët e Deçanit 196
Gjeravica 200
Mali i Zhlebit 206
Kulla e Mazrekajve 212
Dresnik 216

218

PRIZRENI

Kalaja e Prizrenit 220
Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit 226
Katedralja e Zonjës Ndihmëtare në Prizren 228
Xhamia Bajrakli 230
Hamami i Prizrenit 232
Manastiri i Arkangjelit të Shenjtë 234
Ura e Gurit 238
Muzeu Etnologjik i Prizrenit 242
Sheshi i Shadërvanit 244
Sahat Kulla 246
Malet e Sharrit 248
Liçeni i Madh i Jazhincës 256
Prevalla 260
Ujëvarat e Prevallës 266
Brodi 270
Restelica 276
Liçeni i Breznës 280
Malisheva 282

284

FERIZAJ

Muzeu i Ferizajt 286
Teatri "Adriana" 290
Bifurkacioni në Lumin Nerodime 292
Malet e Lubotinit 296
Jezercë 302
Brezovica 304
Kaçaniku 310

318

GJILAN

Kalaja e Pogragjës 320
Teatri i Gjilanit 324
Parku i Qytetit 325
Sahat Kulla 326
Teqja e Gjilanit 328
Atik Xhamia 330
Muzeu i Qytetit të Gjilanit 332
Liçeni i Përlepticës 334
Liçeni i Livoqit 336
Kalaja e Artanës 338
Kamenica 342
Manastiri i Moçarit 348
Ujëvara e Hogoshtit 350

352

GJAKOVA

Ura e Terzive 354
Ura e Fshajtë 358
Shpella e Kusarit 360
Çarshia e Madhe 362
Kodra e Çabratit 366
Parku i Shkugzës 368
Xhamia e Hadumit 372
Sahat Kulla 374
Muzeu Etnografik i Gjakovës 376
Teqja Bektashiane 380
Lumi Krena 384
Lumi i Erenikut 386

Radoniqi 388
Dushkaja 390
Juniku 392
Vreshtat e Rahovecit 396
Krusha e Madhe 400
Ujëvarat e Mirushës 406

Fushat e Lulediellit 408
Fushat e Grurit 410

412

ART I RRUGËS

Newborn 414
Muralet, Arti i Rrugës 416
"1637 - It's not just a number" 418

422

FAUNA

Ariu i Murrmë 424
Shqiponjat 426
Shqiponja Buteo - Buteo 428
Dhia e Egër 430
Lejleku i Zi 434
Kaprolli i Pyjeve Shqiptare 436
Qeni i Sharrit - Deltari Ilir 438
Qethja E Deleve 440
Dhelpra 444
Nëpërka Helmuose - Vipera Ammodytes 446
Ujku 448
Kredharaku 450

Mbi LIBRIN

“Në tokën amë, Kosovë”, në tokën e të parëve tanë aty ku dëgjuam legjenda e thurem histori. Në këtë libër, Banka Ekonomike ju sjellë më shumë se vetëm fotografi, më shumë se vetëm fjalë të thurura, është vet toka jonë. Duke i qëndruar besnik idealit si bankë 100% vendore, Banka Ekonomike gjithmonë ka punuar dhe vepruar për të mirën e vendit, duke synuar në promovimin e një shteti plotë vlerë.

Fotografi të dokumentuara nga fotografët tonë të njohur, duke nisë nga vendet më të fshehta e deri të urbanizmi i hapur. Ky

libër voluminoz përbën një mori të dhënash mbi trojet tona, vende arkeologjike, objekte fetare, botën e gjallë, egërsinë e natyrës, institucionet e kulturës, trashëgiminë që e ruajmë me nder e privilegj.

“Në tokën amë, Kosovë”, janë të dokumentuara foto nga kohë dhe momente të ndryshme, e kjo për të dëshmuar vlerën e një vendi ndonëse i vogël por që ofron shumë. Një vend ku natyra është magjike e historia dhe trashëgimia kulturore janë një ideal të cilin Banka Ekonomike e ruan brez pas brezi.

Z. Shpend Luzha
Kryeshef Ekzekutiv

Hamide Pacolli Gashi
Zv. Kryeshefe Ekzekutive

Arijan Haxhibeqiri
Zv. Kryeshef Ekzekutiv

Në emër të Bordit të Drejtorëve,

Valon Lluka
Kryesues



Prishtina



PARKU I GËRMISË

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Pasuri Natyrore



PARKU I GËRMISË



Errethuar me lisa të gjatë që dhurojnë qetësi dhe freski, Parku Kombëtar i Gërmisë gjendet në Prishtinë në një sipërfaqe prej 1126 ha. Sipas të dhënave thuhet se 75 % e sipërfaqes në Parkun e Gërmisë është e mbuluar me pyje të ruajtura me bashkësi të shpardhit, qarrit, bungut dhe ahut!

Parku është zonë e mbrojtur e natyrës që nga viti 1987 dhe me kalimin e viteve ky park është bërë pikë atraktive edhe për turistët, me fusha të improvizuara të tenisit, basketbollit e fusha të vogla për futboll, e poashtu përveç natyrës piktoreske, ajrit të pastër, Gërmia ka dhe shtegun e saj të vrapimit!





TEATRI KOMBËTAR I KOSOVËS

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Institucion i trashëgimisë kulturore

Në qendër të Prishtinës është i vendosur institucioni më i rëndësishëm teatror në vend, i themeluar që nga paslufta e viteve 1998-99'. Ky institucion ka qenë shtëpi e plot fytyrave të njohura, artistave që ndriçuan emrin e Kosovës me art dhe punë!

Teatri Kombëtar i Kosovës ishte institucioni i parë teatror profesionist në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Disa muaj pas themelimit, teatri u transferua në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë.

Që nga krijimi i teatrit në vitin 1999 e deri tash janë vënë në skenë tekste të shumta të dramaturgjisë kombëtare dhe botërore.





QENDRA PËR RINI DHE SPORT

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Në vitin 1974, gjatë sistemit komunist jugosllav në Kosovë, u hap një konkurs arkitekturor në Prishtinë për të ndërtuar një qendër të re sportive në afërsi të qendrës së qytetit. Kjo ishte fillesa e ndërtimit të një projekti ikonik që do mbetet pjesë e historisë!

Shumica e ndërtesave të viteve '80 në Prishtinë janë transformuar dhe rinovuar, por shumica e tyre e kanë humbur edhe bukurinë fillestare dhe elegancën. Kjo qendër edhe pse është pjesërisht e dëmtuar vazhdon të qëndroj si ikonë e kryeqytetit. Pallati për Rininë dhe Sportin fillimisht u emërua "Boro dhe Ramiz" pas dy luftëtarëve të luftës II partizanë jugosllavë si simbol i unitetit!







BIBLIOTEKA KOMBËTARE

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Institucion edukativ

PRISHTINË


E vendosur në bërthamën e kampusit universitar të Prishtinës, Biblioteka Kombëtare e Kosovës është një nga trashëgimitë kulturore më të vizituara dhe më të përfolura të vendit.

Biblioteka Kombëtare e Kosovës është institucioni më i madh bibliotekar në vend dhe përmbanë një mori ekspozitash dhe gazetash kombëtare të arkivuara. E ndërtuar në vitin

1974, biblioteka si tërësi arkitekturore paraqet një kombinim të kubeve dhe kupolave dhe i takon tipit të arkitekturës të "regjionalizmit të ri".

Biblioteka është funksionale por ka nevojë për modernizim të transportit të librave, dixhitalizim të skedarëve dhe sallave të leximit si dhe intervenime të tjera.







XHAMIA E JASHAR PASHËS

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Objekte fetare

Engjashme me Xhaminë e Çarshisë në arkitekturë dhe dekorim të brendshëm, kjo xhami u ndërtua në shekullin XVI, ndërsa në shekullin XIX iu nënshtrua restaurimit të inicuar nga Mehmet Jashar Pasha, atë botë administrator i Shkupit. Andaj, supozohet se nga ai mori edhe emrin.

Stili arkitekturor i xhamisë paraqet një shembull të stilit të vonshëm të barokut osman. Gjatë viteve '60-të, xhamia ishte pengesë për planin e ri urbanistik, prandaj një pjesë e saj u rrënuar duke i hapur mundësi zgjerimit të rrugës në atë pjesë të qytetit.





XHAMIA E JASHAR PASHËS





MUZEU KOMBËTAR I KOSOVËS

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Institucion i trashëgimisë kulturore


Muzeu Kombëtar i Kosovës është themeluar në vitin 1949 në qytetin e Prishtinës. Si një nga simbolet e kryeqytetit, Muzeu i Kosovës përbëhet nga një koleksion me më shumë se 50 mijë eksponate të profileve të ndryshme të arkeologjisë, teknologjisë, historisë, natyrës, ento-kulturës, folklorit dhe trashëgimisë. Si i tillë, muzeu është pasqyrë e traditës, historisë dhe kulturës të cilat zbulojnë më shumë mbi jetesën e shqiptarëve në kohë të ndryshme – deri tek zhvillimet më të rëndësishme të fundit në Kosovë.

Muzeu i ka mbijetuar kohës së luftës, por që nga viti 1999 koleksioni kryesor i muzeut është marrë në Beograd dhe që nga ajo ditë vazhdon të jetë atje, edhe pse kërkesat dhe petitionet për rikthim në Muzeun e Kosovës janë të vazhdueshme.

Për nga pozicionimi, kjo ndërtesë është e vendosur në pjesën e qytetit që lidhë Qytetin e Vjetër me qendrën e Prishtinës. Stili i saj specifik arkitekturor i përket periudhës së ndikimit austro-hungarez, gjë që shpjegon edhe strukturën unike që ka në krahasim me zhvillimin e arkitekturës së qytetit.









HYJNESHA NË FRON

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

“**H**yjnesha në Fron” është një statujë (figurinë) e vogël terrakote, e gjetur në hapësirat e Tjerrtores në Prishtinë në vitin 1956. Kjo figurinë përfaqëson periudhën neolitike dhe njihet si simbol i Prishtinës.

“Hyjnesha në Fron” është kthyer nga Serbia në Kosovë në vitin 2002, ndërsa 1248 artifakte tjera të vjedhura gjatë kohës së luftës, vazhdojnë të jenë në Serbi edhe sot.





MUZEU ETNOLOGJIK I KOSOVËS

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Institucion i trashëgimisë kulturore

Si pishtari i fundit i mbetur në Çarshinë e Vjetër të Prishtinës, i pasur me histori dhe trashëgimi kulturore, Muzeu Etnologjik i Kosovës është pjesë përbërëse e Muzeut të Kosovës.

I vendosur në kompleksin Emin Gjiku, muzeu daton që nga shekulli i 18-të dhe është i hapur për publikun që nga viti 2006. Në më shumë se një mijë objekte të ekspozuara, pasqyrohen tradita shqiptare që përfshijnë rituale të ndryshme si shënimi i lindjes, martesës e vdekjes. Një hapësirë e veçantë i kushtohet edhe zanateve tradicionale, kostumeve dhe intrumenteve muzikore.

Për nga arkitektura ky muze i përket stilit otoman, të ndërtuar nga guri dhe sipas historisë besohet që para se të kthehej në muze, ishte shtëpia jetuese e familjes Gjinolli.


Ky muze është pasqyrim i shqiptarëve ndër vite; tregon se si familjet jetonin, çfarë rrobash vishnin, e çfarë armë dhe artefakte zotëronin – gjë që e pasuron mjaft detajisht mënyrën e jetesës së kosovarëve gjatë shekujve të kaluar.

Çdo dhomë e muzeut përbën një histori në vete, një rrëfenjë të padëgjuar dhe një përditshmëri të një familjeje të thjeshtë shqiptare ndër vite.



PRISHTINË







HAMAMI I PRISHTINËS

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Objekte fetare

Prishtina është qytet i njohur për kulturë dhe monumente që ruajnë trashëgimin e vendit. Në mesin e hapësirave të trashëgimisë së kulturës është edhe Hamami i Prishtinës. Kjo ndërtesë lidh Prishtinën me vitin 1400 dhe është pjesë e një ansambli emblematic strukturash duke përfshirë shtëpi të shëlbesës dhe qendrës për tregti.

Me kalimin e viteve ky objekt ndërroj qëllim por struktura e tij mbeti e pandryshuar. Madje në vitin 1960 hamami doli nga funksioni primar dhe një pjesë e madhe iu lëshua një biznesi. Vite më vonë, rreth të 90', hapësira u kaplua nga zjarri gjë që prishi strukturën integrale të Hamamit të Prishtinës, gjithsesi një plan për rikonstruktimin e tij tashmë është duke u zbatuar.



SAHAT KULLA

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

E lartuar në 26 metra, Sahat Kulla është një nga monumentet më të vjetra të trashëgimisë kulturore, historia e të cilës daton nga shekulli XIX-të. Është një ndër monumentet më të rëndësishme të arkitekturës utilitare në Prishtinë, e cila përveç historisë shumëvjeçare ka shërbyer edhe si treguese e orës për të shkuar në xhami.

Për nga pozicionimi, Sahat Kulla gjendet në zemrën e zonës kulturo-historike të Prishtinës dhe është ndërtesë me vlera kulturore, historike dhe arkitekturore. Mekanizmi i orës ka funksionuar deri në vitet '70, por në vitin 2001 është vjedhur, së bashku me këmbanën. Që atëherë, mekanizmi i orës është zëvendësuar me orë dixhitale.

Në sahat kullë gjendej këmbana e vjetër e cila gjatë luftërave u soll nga turqit nga Moldavia në Vushtrri, e pastaj në Prishtinë.



KATEDRALJA “NËNË TEREZA”

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Objekte fetare



Einaguruar më 26 gusht të vitit 2010, datë që ka shënuar njëqind vjetorin e lindjes së Nënë Terezës, katedralja e emëruar sipas saj ka filluar të ndërtohet në vitin 2011 dhe njihet si një nga ndërtesat më të larta në Prishtinë.

Propozimi për ndërtimin e Katedralës “Nënë Tereza”, u dha qysh në vitin 2007 dhe ideja për ndërtimin e një katedrale të tillë ishte propozuar nga ish-Presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova. Në atë kohë, ky ndërtim kishte hapur polemika në qarqe të ndryshme në Kosovë.

Në katedrale është e vendosur edhe Administrata Apostolike e cila më parë gjendej në Prizren.





GOLLAKU

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Pasuri natyrore



Gollaku ndryshe i njohur edhe me emrin Gallapi, është trevë malore në veri dhe lindje të Prishtinës. Kjo zonë e pasur natyrore ndodhet mes lumit Batllavë dhe Krivareka dhe shtrihet deri në Serbinë jugore duke përfshirë edhe Medvegjën me rrethinë.

Kjo shtrirje e gjerë e kësaj treve përfshinë gjithashu fshatrat e Komunës së Podujevës, Kamenicës, Artanës, të Komunës së Graçanicës, disa fshatra të Komunës së Gjilanit, madje popullsia e kësaj ane këtë trevë e quan edhe Malësia e Gallapit.



QYTETI ANTIK I ULPIANËS

LOKACIONI: Graçanicë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Historia dhe gërmimet e gjetura arkeologjike janë padyshim një trashëgimi e madhe e Kosovës. E tillë është edhe Ulpiana.

I njohur edhe si Justiniana Secunda, qyteti antik i Ulpianës është themeluar në fillim të shekullit II nga perandori Trajan. Gërmimet arkeologjike kanë dëshmuar gjurmë të jetës pararomake,

që e vërteton se Ulpiana ka qenë qytet Ilir me rëndësi të lartë për Mbretërinë Dardane.

Gërmimet arkeologjike të zhvilluara që nga viti 1954, e që vazhdojnë edhe sot, kanë nxjerrë në dritë një mori gjetjesh jashtëzakonisht interesante nga një qytet i lulëzuar i Perandorisë Romake, të cilat sot na ndihmojnë të kuptojmë më mirë historinë kulturore të Kosovës.







LIQENI I BADOVCIT

LOKACIONI: Graçanicë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Liqeni i Badovcit është një vend unik për t'u vizituar, një nga destinacionet perfekte për t'i shpëtuar zhurmës së qytetit. Ky liqe është një nga akumulimet kryesore të Kosovës për përdorim të ujit të pijshëm i cili furnizon Prishtinën me rrethinë.

Në kapacitet të plotë, liqeni është 3.5 kilometra i gjatë dhe 100 metra i gjerë. Thellësia maksimale është 30 m dhe ka vëllim total prej 26 milionë metër kubik ujë.







FSHATI MAREC

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Pasuri natyrore



Fshati Marec me një sipërfaqe prej 112 km² është ndër më të mëdhenjtë e Kosovës, e madje në vitet e 70-ta kishte afër 650 shtëpi apo mbi 3 mijë banorë. Që nga ajo kohë kur filluan shpërnguljet e para, aty nisi të zvogëlohet numri i banorëve, kurse pas luftës së fundit shpërngulja mori përmasa më të mëdha dhe tani kanë mbetur vetëm dhjetëra shtëpi. Me kalimin e viteve fshati Marec ka marrë edhe emrin Merion, por themelimi i fshatit

është një histori gojdhënash, madje në shkrimet e vonshme potencohet si ndër vendbanimet e hershme që nga koha Ilire dhe ekzistimi i minierave të vjetra Romako-Bizantine.

Ka edhe shumë legjenda rreth fshatit e që thonë se banorët e parë të Marecit ishin autokton edhe në mijëvjeqarin e parafundit të epokës së vjetër. Madje thuhet se zejtarët Ilir të Dalmacisë kishin ardhur të parët në breg të lumit të Marecit.





PARKU I BLINAJËS

LOKACIONI: Lipjan

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Parku Kombëtar i Blinajës gjendet në komunën e Lipjanit afër fshatit Magurë. Rreth 32 km larg nga Prishtina, ky park ka një pamje përrallore dhe përfshinë 33 liqej artificial që i shërbejnë faunës së kësaj zone. Parku i Blinajës njihet për një botë të gjallë të larmishme të përbërë nga mbi 900 kafshë të egra.

Sipas të dhënave bota e gjallë bimore përfaqësohet nga një numër i madh llojesh autoktone, si dhe nga fauna e egër. Vegjetacioni është i begatshëm dhe i llojlojshëm si rezultat i proceseve historike evolutive dhe kushteve të përshtatshme gjeografike. Blinaja përfaqëson një lloj të mbyllur të vend gjuetisë, çka do thotë se nuk ka lëvizje të lirë të faunës së kultivuar dhe grabitqarëve natyror.



JANJEVA

LOKACIONI: Lipjan

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore



Enjohur për minierat e arit dhe argjendit qysh para shumë vitesh dhe e konsideruar si vendbanim i lashtë, Janjeva shquhet për historinë e saj që daton që nga shekulli IV. Bazuar në dokumentet e vjetra, Janjeva është krijuar nga njerëzit e Raguzës dhe Kotorit. Ajo që e bën edhe më të shquar, është jetesa multietnike mes turqve, kroatëve, romëve, ashkalinjëve si dhe boshnjakëve. Të gjitha këto komunitete bashkëjetojnë në tolerancë, pa marrë parasysh dallimet etnike dhe fetare që kanë mes tyre.





SHPELLA E GADIMËS

LOKACIONI: Lipjan

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Shpella e Gadimës gjendet në fshatin Gadime në afërsi të Lipjanit dhe ka gjatësi prej 1500 metra. Në të ndodhen kati i mesëm që është i hapur për vizitorë, kati nënujor dhe kati i sipërm. Gjatë verës temperatura në brendi të shpellës është konstante 13 gradë celsius ndërsa gjatë dimrit varion nga 11 në 13 gradë. Shpella mendohet të jetë e vjetër rreth 80,000 vjet.

Kjo shpellë është një nga bukuritë natyrore që e karakterizon vendin tonë

si vend të pasuruar me bukuri të rralla. Gjatë vitit, shumë turistë – shqiptarë dhe të huaj, vijnë për ta vizituar këtë shpellë për shkak të strukturës së rrallë që ka. Shpella është e pasur edhe me dukuri të tjera natyrore, të tilla si liqeni, madhësia e të cilit është 15-25 metra. Çka e karakterizon edhe më shumë këtë shpellë është se nga kristalet që gjenden brenda, vetvetiu janë formuar simbole dhe portrete si ato të peshkut, mjekrra e Skënderbeut, gjarpëri dhe Romeo e Zhulieta.





SHPELLA E GADIMËS



LIQENI I BATLLAVËS

LOKACIONI: Podujevë

KATEGORIA: Pasuri natyrore



Me thellësi prej 48 metrash dhe sipërfaqe prej 3,29 km², liqeni i Batllavës është liqen artificial i Kosovës, i ndërtuar në vitet e 70-ta dhe gjendet në fshatin Batllavë të Podujevës.

Sipas të dhënave ky liqen ka tri nivele dhe thuhet se uji më i mirë është nga mesi. Uji i liqenit përdoret

për ujësjellës në Prishtinë. Pra nga centrali, uji shkon në fabrikën që është në një mal aty afër, futet për pastrim, klorifikim dhe pastaj shpërndahet nëpër dy gypa. Njëri gyp shkon për në Prishtinë, tjetri gyp shkon për në Podujevë që ka kapacitet prej 250 litra në sekondë, ndërsa në tërësi brenda vitit ujësjellësi nga liqeni nxjerr 34 milion tonë ujë!





LUMI I LLAPIT

LOKACIONI: Podujevë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Lumi i Llapit është lumi i cili buron në malet e Albanikut, ndërsa si burim i tij merret bashkimi i lumit Murgulla me Latë të Sllatinës në fshatin Pollatë të Besianës, duke rrjedh nëpër lugina relativisht të ngushta dhe të rrëpita.

Sipas të dhënave gjerësia e lumit ndryshon për shkak të dinamikës që kanë lumenjtë, ajo sillet në nivele normale rreth 9-12 metra në pikën hidrometrike në Lluzhan, thellësi deri në 1,2m. Gjatësia e këtij lumi në komunë është 61 km, ndërsa deri në grykëderdhje në lumin Sitnica 76,8 km dhe sipërfaqe të pellgut 948.9 km².



LIQENI I VASILEVËS

LOKACIONI: Drenas

KATEGORIA: Pasuri natyrore



Liqeni i Vasilevës ndodhet në mes të Komunës së Drenasit dhe asaj të Fushë Kosovës, emrin e mori nga fshati Vasilivë ndërsa përveç këtij liqeni në afërsi ndodhën edhe disa liqene tjera. Është i pasur me Florë dhe Faunë dhe është i rrethuar nga malet e gjelbëruara të Gospojës që ndodhet në një pozitë gjeografike të thellë dhe ka një sipërfaqe prej 6ha me thellësi prej 25m.



KALAJA E VUÇAKUT

LOKACIONI: Drenas

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Evendosur në një lartësi mbidetare prej 940m, Kalaja e Vuçakut ndodhet rreth 12km në jugperëndim të Drenasit.

Kjo kala është e ndërtuar mbi dy kreshta shkëmbore, dhe nga banorët

vendas njihet si Gradina e madhe dhe Gradina e vogël.

Gjetjet arkeologjike dëshmojnë që jeta në këtë Kala ka filluar që nga periudha e gurit (neoliti) dhe ka vazhduar edhe në periudhën e antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme.



GURI I PLAKËS

LOKACIONI: Drenas

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Në lidhjen e fshatrave Dritan – Dobroshec të Drenasit ndodhet monumenti natyror gjeomorfologjik i njohur me emrin Guri i Plakës.

Ky monument është i pozicionuar në një pozitë mjaft interesante rrëzë masivit malor të Çyçavicës. Një karakteristikë dalluese dhe e rëndësishme e këtij monumenti është se në mes të këtij guri kalon hekurudha dhe treni Prishtinë - Pejë. Dikur ky gur ishte i plotë por me ndërtimin e linjës hekurudhore në vitin 1936 është dashur që Guri i Plakës të ndahet në dy pjesë dhe në mes të kalojë treni.





A landscape of rolling green hills under a sunset sky. Several wind turbines are visible on the hills. The sky is filled with soft, orange and pink clouds. The overall mood is serene and natural.

Mitrovica



MITROVICË



MONUMENTI I MITROVICËS

LOKACIONI: Mitrovicë

KATEGORIA: Monument i trashëgimisë kulturore

Engulitur në të ashtuquajturën kodër minatorësh në veri të Mitrovicës, ky monument është mjaft domethënës për qytetin.

U ndërtua në vitin 1973, monumenti iu kushtua minatorëve të qytetit të cilët humbën jetën gjatë Luftës së Dytë Botërore. Dy kolona që mbajnë një karrocë minerare përfaqësojnë traditën e minierave të qytetit, kurse nga aspekti metaforik ishte krijuar për të përfaqësuar bashkëjetesën paqësore midis dy komuniteteve në Jugosllavinë e pas luftës.





LIQENI I MITROVICËS

LOKACIONI: Mitrovicë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Liqeni i Mitrovicës është liqen artificial me gjatësi prej 1.8 km, gjerësi deri në 150 metra dhe thellësi deri në 4 metra. Liqeni, shtrihet në hapësirën përgjatë rrjedhës së lumit Ibër, në mes Mitrovicës dhe fshatrave: Suhodolli i Poshtëm, Suhodolli i Epërm, Zhabari i Poshtëm e deri në Gushacë e Vinarcë të Poshtme. Liqeni i Mitrovicës gjendet vetëm pak metra larg nga qyteti dhe së fundmi kjo zonë është shndërruar në atraksion për qytetarë nga të gjitha vendet e Kosovës.







MUZEU I QYTETIT

LOKACIONI: Mitrovicë

KATEGORIA: Institucion i trashëgimisë kulturore

Me mbi 1000 artefakte të ndryshme arkeologjike janë të ekspozuara në muzeun e qytetit të Mitrovicës. Ky muze i cili u ndërtua në vitin 1952, aktualisht aktivitetin e zhvillon në objektin e ish Armatës Jugosllave në qendër të qytetit.

Në kuadër të Muzeut të Mitrovicës ndodhen edhe mbi 800 eksponate etnologjike, e të cilat e paraqesin dhe e përfaqësojnë diversitetin lokal. Muzeu disponon gjithashtu edhe materiale dhe dokumentet historike si dhe koleksione gjeologjike dhe numizmatike.







HAMAMI I MITROVICËS

LOKACIONI: Mitrovicë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Hamami i Mitrovicës daton nga shekulli XVIII. Sipas pronarëve të tij, hamami ishte ndërtuar nga Sulejman Pashë Berisha dhe nipi i tij Zejnullah Beg Berisha. Ndërtimi i kësaj banje me stil tipik oriental zgjati dy vite. Hamami ishte funksional deri në maj të vitit 1959.

Hamami i Qytetit përjetoi disa herë ndryshime në emër të modernizimit, punë të cilat u kryen pa përgjegjësi dhe pa profesionalizëm, me çka Hamami i Qytetit përjetoi dëmtime. Objekti i hamamit ishte në përdorim si Muze i Qytetit deri në nëntor të vitit 2009, e që nga ky vit objekti i është kthyer trashëgimtarëve të ish-pronarit dhe tani ka funksionin e lokalit gastronomik.



MANASTIRI I SOKOLICËS

LOKACIONI: Mitrovicë


KATEGORIA: Objekte fetare

Manastiri i Sokolicës është një monument i trashëgimisë kulturore në Boletin të Kosovës, i kategorisë "Arkeologjik".

Ky manastir gjendet në majën e kodrës së Sokolicës dhe thuhet se është dedikuar për nderin e Virgjëreshës së Shenjtë, e nga të dhënat e vetme të ruajtura ndër kohë, thuhet se manastiri është ndërtuar midis shekullit XIV dhe XV.

Në manastir gjendet skulptura e punuar nga mermeri ku shihet figura e Virgjëreshës me Krishtin e cila mendohet të jetë nga vitet 1312-1316.





MINIERA E TREPÇËS

LOKACIONI: Mitrovicë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Trepça, ky emër i lashtë ka prejardhjen e ngjashme me historinë dhe historinë e vjetër e një miniere e cila në fillim punonte në kapacitete të vogla. Në kohën e lashtë miniera kishte tri furra për shkrirje, po nga kjo arsye rrjedh edhe pjesa e parë emrit, pra TRE. Kurse pjesa e dytë PÇA rrjedh nga "poça", në kuptimin e pjekjes! Trepça është një minierë e lashtë plumbi, zinku, argjendi, kristaleve dhe mineraleve të ndryshme në Kosovë, gjegjësisht në komunën e Mitrovicës. Në vitet e komunizmit kjo minierë ishte shumë e njohur për zhvillimin ekonomik që sillte!





MUZEU I KRISTALEVE TË KOSOVËS “TREPÇA”

LOKACIONI: Mitrovicë

KATEGORIA: Pasuri natyrore/Institucion i trashëgimisë kulturore

Kosova ka pasuri të shumta e një prej tyre është Muzeu i Kristaleve “Trepça”, i cili shtrihet në mes të maleve të Pretenit dhe atyre të Kutllovcit.

Ky muze i veçantë është i pozicionuar skaj rrugës që shpie për në malet e bukura të Shalës së Bajgorës dhe është “galeri” e mijëra kristaleve që janë gjetur në Minierën e Trepçës. Muzeu është pasuri e lashtë nëntokësore, minerale dhe kristale të cilat kanë një bukuri mahnitëse. Në këtë muze janë të ekspozuara mbi 1900 eksponate, me 65 lloj kristalesh.

Përveç kristaleve të Trepçës, në muze janë ekspozuar edhe mjete të vjetra pune me të cilat kanë punuar xehetarët ndër vite.





MUZEU I KRISTALEVE TË KOSOVËS "TREPÇA"




Galenit
PbS
Trepça Stantem



MITROVICË



NË TOKËN AMË
Kosovë



UJËVARA E TREPÇËS

LOKACIONI: Mitrovicë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Në veri të Mitrovicës janë të pozicionuara ujëvarat e Trepçës, duke ofruar një pamje magjike. Kjo pasuri natyrore është një vend i përkryer për admiruesit e natyrës e të gjithë ata që dëshirojnë të eksplorojnë perlat e qytetit të Mitrovicës. Ujëvara rrjedh gjatë tërë vitit, në verë duke ofruar freski kurse gjatë dimrit varësisht nga i ftohti mund edhe të ketë ngrirje të ujit.





KALAJA E ZVEÇANIT

LOKACIONI: Mitrovicë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Evendosur në veri-perëndim të qytetit të Mitrovicës, Kalaja e Zveçanit njihet edhe si Kalaja gurzeze ose Kalaja e Mitrovicës. Me vete kjo kala ka një histori të lashtë, e ndërtuar në majë të një vullkani të shuar, me pamje nga lumi Ibër. Lashtësia e saj ende nuk është evidentuar sa duhet, por besohet se në parahistori e deri vonë ishte shkatërruar dhe rindërtuar disa herë. Kalaja përmban gjurmë të shumta të lashtësisë dardane, e më pas gjurmë të perandorisë romake dhe bizantine.



KULLA E ISA BOLETINIT

LOKACIONI: Mitrovicë

KATEGORIA: Monument i trashëgimisë kulturore

Kompleksi i kullave të Boletinëve në fshatin Boletin të komunës së Zveçanit, i ngritur në fund të shekullit XIX.

Ky kompleks tani vizitohet nga mijëra qytetarë gjithandej trojeve shqiptare, pasi është shtëpia e heroit kombëtar Isa Boletini. Si të tilla kullat qëndrojnë ende

mbi themelet e tyre, të forta, të larta, duke ngërthyer brenda vetes shumë histori, dokumente, fotografi e objekte, të cilat flasin për një epokë në vete dhe të lavdishme të heroit shqiptar. Sipas të dhënave thuhet se ky kompleks gjatë luftërave që u zhvilluan u shkatërrua disa herë me kalimin e dekadave.

KULLA E ISA BOLETINIT





LIQENI I UJMANIT

LOKACIONI: Mitrovicë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Liqeni i Ujmanit i njohur edhe si Liqeni i Gazivodës është liqen artificial që shtrihet në pjesën veriperëndimore të Kosovës.

Ky liqe shtrihet në rrjedhën e mesme të lumit Ibër dhe në një distancë prej rreth 15 km në veriperëndim të Mitrovicës midis malit të Rogoznës në verilindje dhe atij të Mognës në jugperëndim.

Shtrati i liqenit ndjek formën gjarpëruese të luginës së lbrit, nga i cili edhe furnizohet kryesisht me ujë.





SHALA E BAJGORËS

LOKACIONI: Mitrovicë

KATEGORIA: Pasuri natyrore



Shala e Bajgorës është trevë malore që shtrihet mes luginës së Ibrit dhe Llapit në rrëzat e Kopaonikut. Emri Shalë e Bajgorës ka mbetur nga fisi Shalë dhe fshati qendror Bajgorë.

Bjeshkët e Shalës së Bajgorës janë mjaft të pasura me shtigje ideale për skijim në borë dhe mbi bar. Për nga ana gjeografike

Shala e Bajgorës kufizohet me Mitrovicën, Vushtrrinë, Zveçanin, Kastriotin e Besianën ndërsa në pjesën veriore kufizohet me Serbinë.

Ka pasuri të mëdha natyrore dhe bujqësore, duke përfshirë arin, argjendin, bronzin, aluminin, bakrin dhe hekurin.



SHALA E BAJGORËS







KALAJA E VUSHTRRIË

LOKACIONI: Vushtri

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore



MITROVICË



Enjohur si monumenti identifikues i qytetit të Vushtrrisë dhe e vendosur në qendër të qytetit, Kalaja e Vushtrrisë është monument historik që i ka rezistuar periudhave të ndryshme kohore. Kalaja e vjetër dhe unike thuhet se u ndërtua gjatë periudhës së hershme Iliro-Dardane dhe si e tillë përbëhet prej strukturave ndërtimore me shtresime nga periudha të ndryshme historike.

Për nga ndërtimi dhe arkitektura i takon tipit fushor dhe ashtu si kalatë tjera të kësaj periudhe, Kalaja e Vushtrrisë është e ndërtuar nga shtresa të mureve të trasha dhe të larta të cilat i dhurojnë edhe më shumë identitet. Me kalimin e viteve, kjo kala ka përjetuar dëmtime dhe është rindërtuar disa herë, e po ashtu ka shërbyer edhe si qendër e rëndësishme administrative e tregtisë.



Përkundër ndikimeve nga faktorë të ndryshëm përgjatë historisë, kalaja e ka ruajtur originalitetin e saj. Në vitet e fundit ajo është rinovuar dhe shërben si monument për zhvillimin e aktiviteteve kulturore.

KALAJA E VUSHTRRIË





URA E GURIT

LOKACIONI: Vushtri

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Një nga monumentet e rralla arkitektonike dhe hidroteknike në qytetin e Vushtrrisë është Ura e Vjetër e Gurit. Sipas hulumtimeve, llogaritet të jetë ndër urat më të vjetra të këtij lloji në Kosovë.

Sipas të dhënave nga studimet e historisë, Urën e Gurit e përmendin edhe udhëpërshkrues të kohës, si francezi Filip Difren-Kane (1573) i cili, përveç të tjerave thotë: "...prej aty

arritëm në Vushtri, qytet i madh me Xhami të shumta dhe me Urë të madhe të Gurit!"

Që në vitet e para të ndërtimit, ura i lidhte fshatrat afër Çyçavicës me qytetin e Vushtrrisë dhe nëpërmes Grykës së Klysyrrës e lidhte Rrafshin e Kosovës me rajonin e Drenicës. Në këtë urë kalonte rruga e cila e lidhte qytetin e Vushtrrisë me stacionin e trenit në fshatin Shtruerë.

Në lidhje me vjetërsinë e urës ka versione të ndryshme por dominojnë mendimet sipas të cilave ajo është ndërtuar në kohën e Perandorisë Osmane apo edhe më herët në kohën e Perandorisë Romake. Ura është ndërtuar me gurë të vjetër antik me trashësi të madhe, gjë që e bën atë edhe më të veçantë.



URA E GURIT





HAMAMI I GAZI ALI BEUT

LOKACIONI: Vushtri

KATEGORIA: Objekte fetare



Hamami i Gazi Ali Beut gjendet në bërthamën e qendrës së vjetër të qytetit të Vushtrrisë. Sipas të dhënave mendohet që ky hamam është ndërtuar në fund të shek. XIV dhe fillim të shek.XV. Objekti sanitar publik kishte funksion banjoje i cili ishte në shërbim për të dy gjinitë. Me kalimin e viteve ky objekt ka humbur esencën e përdorimit, mirëpo ende ruhet si një trashëgimi kulturore në qytetin e Vushtrrisë, duke përcjellë histori dhe tërhequr turist si një atraksion për vendin.



KOMPLEKSI MEMORIAL "ADEM JASHARI"

LOKACIONI: Prekaz, Skenderaj

KATEGORIA: Monument i trashëgimisë kulturore

Historitë nga lufta janë një memoar i pashlyer i një populli. Tregimin e një lufte të ftohtë e tregon Kompleksi Memorial "Adem Jashari", i cili gjendet në Prekaz, ku përveç shtëpive të shndërruara në muze, gjenden edhe të gjitha varret e të rënëve në luftë të familjes Jashari. Këto varre janë vulë në historinë e popullit tonë.

Ky kompleks ndër të tjera rikujton luftën e ushtarëve që ranë për lirinë e vendit. Në mëngjesin e hershëm të 5 marsit 1998 forca të shumta policore dhe ushtarake serbe me mjete të blinduara kishin sulmuar shtëpitë e Jasharëve në Prekaz, aty ku ishte komandanti Adem Jashari dhe e gjithë familja e tij. Për të rënë heroikisht për liri në Prekaz u luftua përgjatë 3 ditëve, 5, 6 dhe 7 marsit. Ngjarjet e këtyre datave shënojnë mbylljen e një kapitulli të vjetër, një lufte që mori shumë jetëra dhe hapi një kaptinë të re për Kosovën.





KOMPLEKSI MEMORIAL 'ADEM JASHARI'



KOMPLEKSI MEMORIAL "ADEM JASHARI"





Peja



ÇARSHIA E VJETËR E QYTETIT

LOKACIONI: Pejë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Çarshia e vjetër në Pejë daton që nga shekulli i XV dhe për vite me radhë konsiderohet si një lloj qendre tregtare e qytetit. Rruga e gjatë që e përshkon Çarshinë e vjetër është e rrethuar nga dyqanet tipike orientale.

Zejtatarët kishin një ndikim të madh në kohën e krijimit të Çarshisë, madje ka ende prej tyre që ushtrojnë këtë zana në këtë zonë! Kjo pjesë e Pejës paraqet një zonë me trashëgimi kulturore, e njohur për rëndësinë e zhvillimit ekonomik që ka ndikuar në qytetin e Pejës dhe në regjion.





HAMAMI I HAXHI BEUT

LOKACIONI: Pejë

KATEGORIA: Objekte fetare

Gërmadhat e Hamamit të Vjetër në Pejë i quajtur edhe Hamami i Haxhi Beut janë monument i trashëgimisë kulturore të kategorizuara si monumente arkeologjike! gjendjes fillestare, origjinale, pra në një masë dhe formë e ruan autenticitetin e kohës së ndërtimit! Donator i këtij objekti monumental ishte Haxhi Beu nga Peja.

Ky hamam u ndërtua në gjysmën e dytë të shek. XV dhe është një ndër ndërtimet shoqëro – publike i ruajtur deri në ditët tona me mjaft elemente të Hamami si ndërtim klasik i arkitekturës islamo-shqiptare u ndërtua në mahallën e Sinan Vojvodës, kjo ishte periudhë kur, Peja, kishte vetëm 18 mahalla.



MUZEU I PEJËS

LOKACIONI: Pejë

KATEGORIA: Institucion i trashëgimisë kulturore

Konaku i vjetër i Tahir Beut, një shtëpi e vjetër tradicionale e Pejës e ndërtuar në Shek. XVIII, vendosur në sheshin Haxhi Zeka në një pikë mjaft qarkulluese e cila lidh pjesën e qendrës së Pejës me Çarshinë e vjetër. Sot ky konak shërben si muze në të cilën ruhet tradita dhe historia e pejanëve.

Muzeu përbëhet nga kati përdhes dhe kati i parë, janë 2 ekspozita (etnologjike dhe arkeologjike) me afro 2000 ekspozitate, të cilat prezantojnë historinë e Pejës në periudha të ndryshme kohore, duke filluar nga ato Ilire, e deri në ditët e sotme.





KOMPLEKSI I MULLIRIT TË HAXHI ZEKËS

LOKACIONI: Pejë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore



Një aset i trashëgimisë kulturore në Pejë, një ndërtesë mbresëlënëse arkitektonike, kompleksi i mullirit Haxhi Zeka, daton që nga shekulli XIX, gjerësisht nga periudha e Austro – Hungarisë. Ky objekt i rëndësishëm i përkiste atdhetarit të kombit dhe luftëtarit të dalluar të luftës për pavarësi, Haxhi Zeka. Arkitektura, plani dhe ndërtimi i tij e bëjnë këtë mull të ketë ende një sharm unik. Madje veçanti e objektit është lartësia, pasi koha në të cilën u ndërtua ishte më komplekse dhe mulliri ishte objekti më i lartë në vend. Ky kompleks përveç rëndësisë historike që ka, shërben edhe si qendër kulturore dhe si qendër informacioni për faunën dhe florën e maleve të Kosovës.







PARKU I KARAGAQIT

LOKACIONI: Pejë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Qyteti i Pejës njihet si një vend atraktiv me një listë të gjatë të vendeve të bukura që kanë ndikuar në zhvillimin e turizmit.

Në këtë listë bën pjesë edhe Parku i Karagaqit si bukuri atraktive natyrore e krijuar nga dora e njeriut. Ky lokacion mjaft i shfrytëzueshëm nga qytetarët, ndryshon në çdo stinë të vitit dhe është unike në çdo stinë për nga pamjet.

Parku mendohet të jetë krijuar në vitin 1929 dhe në qendër të parkut është i vendosur liqeni i rrethuar nga shtigjet e vrapimit, fushat e sportit, këndet për ushtrime si dhe këndet për lojrat e fëmijëve.

Në përbërje të parkut ka një llojlojshmëri të florës ndërsa nën gjelbërimin e tyre strehohen edhe gjallesa të ndryshme si zvarranik dhe lloje të ndryshme të shpezëve.





PARKU KOMBËTAR I BJESHKËVE TË NEMUNA

LOKACIONI: Bjeshkët e nemuna

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Ishtrirë në një sipërfaqe prej 62,488 hektarësh Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna ndodhet në perëndim të Kosovës, në Rajonin e Pejës dhe Gjakovës.

Ky park u themelua me qëllim të mbrojtjes së ekosistemit, biodiversitetit si dhe trashëgimisë kulturore e historike të kësaj pjese të Bjeshkëve të Nemuna. Njihet si vazhdimi më i rëndësishëm i Alpeve Dinarike.



LIQENI I KUQISHTËS

LOKACIONI: Bjeshkët e nemuna

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Irrethuar me male të larta dhe shkëmbinj, 2341 metra mbi Kuqishtë ndodhet Liqeni i Kuqishtës i njohur ndryshe si Liqenati i Madh i cili ndodhet në Bjeshkët e Nemuna të cilat shtrihen në pjesën perëndimore të Kosovës.

Liqeni i Liqenatit është në një lartësi mbidetare 1970 metra mbi nivelin e detit dhe është një prej atyre destinacioneve i cili padiskutim do ju bëj ti harroni plazhet.

Liqeni i Liqenatit shquhet për ujë të kristaltë dhe të ftohtë, i cili ofron qetësi për të gjithë ata që e vizitojnë.









LIQENI I ZEMRËS

LOKACIONI: Bjeshkët e nemuna

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Natyra është një krijues mahnitës, pamjet e të cilës janë përrallore, e një i tillë është edhe Liqeni i Zembrës. Liqeni i Zembrës është një liqe malor në Kosovë, i cili ndodhet rreth 400 metra nga kufiri me Shqipërinë.

I vendosur në qendër të Bjeshkëve të Nemuna, ky liqe ka lartësi mbidetare deri në 2539m. Për nga pamja dhe forma e tij, Liqeni i Zembrës i ngjan Liqenit të Gjeravicës.







PARKU NACIONAL I RUGOVËS

LOKACIONI: Rugovë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Bjeshkët e Rugovës veçohen me karakteristika unike dhe përbëhen nga 13 fshatra me lartësi të ndryshme malore. Kjo trevë ka potencial të papërshkrueshëm dhe biodiversitet që ofron mundësi për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit.

Pothuajse në të gjithë hapësirën e Bjeshkëve të Rugovës mund të hasësh në mrekullitë e fshehura nën egërsinë malore të florës, ndërsa një pasuri e madhe e këtyre maleve janë edhe liqenet madhështore që gjenden në lartësi prej 1860 m në Liqenat të Kuqishtës. Pastaj është Lumbardhi i cili është atraksion unik me rrjedhë shumë të rrëpishme gjatë pranverës, ujëvarat e bukura dhe tërheqëse në fshatin Malaj, flora dhe

fauna e shpërndarë në gjithë regjionin, panorama e masivit të Gurit të Kuq, Hajlës dhe panorama tjera që mund ti përjetosh nga bjeshkët e ndryshme.

Kjo trevë malore ofron një numër të madh të aktiviteteve rekreative në natyrë. Ajo që e bën edhe më të veçantë këtë hapësirë është kultura dhe traditat e banorëve lokal e cila është ruajtur dhe bartur brez pas brezi ndër shekuj dhe është prezente edhe në ditët e sotme. Lojërat Tradicionale të cilat organizohen çdo vit me përkushtim të plotë nga banorët që ruajnë traditën e lashtë të Bjeshkëve të Rugovës, janë vetëm një nga organizimet e shumta përmes së cilave shënohet kultura e kësaj treve.





BOGE



LIQENI I DRELAJVE





SHTUPEQ I VOGËL







VIA FERRATA NË PEJË

LOKACIONI: Rugovë
KATEGORIA: Atraksion turistik

PEJË

Via Ferrata, që do të thotë “shtegu i hekurt”, është shteg i siguar përmes një fije të çeliktë në shkëmbinj, e cila kalon përgjatë masiveve shkëmbore të Grykës së Rugovës në lartësi të ndryshme dhe ofron përjetim të aventurave, argëtim dhe adrenalinë. Një të tillë e gjeni vetëm 3 kilometra nga qendra e qytetit të Pejës, brenda Bjeshkëve të Rugovës. Në Pejë gjenden 4 via ferrata të cilat kanë nivele të ndryshme të vështirësisë. Gjatësia e tyre fillon nga 450m deri në 1km.

- Via Ferrata “Ari” (Gjatësia 450 m/ngjitje 1 orë e 30 min)
- Via Ferrata “Mat” (Gjatësia 500 m/ngjitje 1 orë e 30 min)
- Via Ferrata “Marimangat” (Gjatësia 1 km/ngjitje 3 orë e 30 min)
- Via Ferrata “Shpellat” (Gjatësia 700 m/ngjitje 2 orë e 30 min)



DRINI I BARDHË

LOKACIONI: Radavc


KATEGORIA: Pasuri natyrore

Një nga ujëvarat përrallore të Kosovës, burimi i Drinit të Bardhë, buron nga gurra e shpellës së Radavcit në lartësi mbidetare prej 586 m. Drini i Bardhë gjarpëron për 122 km në drejtim veri-jug, duke mbledhur në vete edhe ujërat e Lumbardhit të Pejës, Erenikut dhe Lumbardhit të Prizrenit. Me një madhësi prej 4646 km², bazeni i Drinit është më i madhi nga 4 bazenet ujëmbledhëse të Kosovës.

Burimi i Drinit të Bardhë është një nga burimet më të rëndësishme të Kosovës dhe përveçse furnizon qytetin e Pejës me ujë të pijshëm, vizitohet nga turistët gjatë gjithë vitit.

Qasja për në burim apo tek "Ujëvara e Drinit të Bardhë" mund të bëhet nga dy anë, ku njëra anë shpie nga rruga e hidrocentralit për të ndjekur pastaj shtegun e këmbësorëve përgjatë bukurisë së lumit Drini i Bardhë që qarkullon përmes kanjonit në gjatësi deri në 400 m.







SHPELLA E RADAVCIT

LOKACIONI: Radavc


KATEGORIA: Pasuri natyrore

Enjuhur si “Bukuroshja e Fjetur”, në fshatin Radavc të Pejës ndodhet një nga shpellat më të bukura buzë burimit të Drinit. Kjo shpellë, e emëruar si “Shpella e Radavcit” është trashëgimi natyrore e Kosovës rreth 11 km larg qytetit të Pejës. Kjo hapësirë, paraqet llojin tipik të shpellave të burimeve.

Gjatësia e përgjithshme e të gjitha kanaleve të shpellës së Radavcit është 1420 m, ndërsa kanalet horizontale janë të gjata 680 m.

Sipas të dhënave gjeografike kjo shpellë përbëhet prej katër elementeve morfologjike: galeritë kryesore, galeritë e majta, galeritë e poshtme dhe kanalet vertikale.

Galeria kryesore përbehet prej tri pjesëve: kanalit hyrës, galerisë qendrore dhe kanalit të vaskave. Kanali me vaska gjendet në vazhdimin e galerisë qendrore dhe ka një gjatësi prej 76 m, gjerësi prej 4–8 m dhe lartësi mes 3-5 m.





BURIMI I ISTOGUT

LOKACIONI: Istog

KATEGORIA: Pasuri natyrore


Komuna e Istogut, shtrihet në veriperëndim të Kosovës dhe është pjesë e rrafshit të Dukagjinit.

Në këtë qytet ndodhet një ndër burimet më të njohura në Dukagjin, Burimi i Istogut, i cili përveç që shërben për furnizim për banorët e kësaj ane, tashmë është shndërruar edhe në atraksion turistik.

Sipas të dhënave të publikuara nga ekspertet e hidro-gjeologjisë, thuhet se ky ujë është i mineralizuar me kalcium dhe magnez, ndërsa në aspektin bakterial është uji më i mirë në Evropë.









BJESHKËT E DEÇANIT

LOKAIONI: Deçan

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Bjeshkët e Deçanit kanë një florë dhe faunë të pasur me llojet e drurëve halor dhe gjetherënës që janë të përhapura në gjithë brezin malor. Në njërën anë Bjeshkët, në anën tjetër lumenjtë, Lumbardhi i Deçanit dhe Lumabrdhi i Lloqanit, shkrihen me qiellin. Këta dy lumenj, burojnë në pjesët më të larta të Bjeshkëve të Deçanit.







GJERAVICA

LOKACIONI: Deçan

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Maja më e lartë në Alpet Shqiptare me lartësi mbidetare 2656 m, Gjeravica, është një nga bukuritë e njohura të Kosovës. Kjo maje malore gjendet në perëndim të Kosovës, në vargmalet e Bjeshkëve të Nemuna që ndajnë kufirin shtetëror të komunës së Deçanit me Shqipërinë. Gjeravica është po ashtu njëra nga atraksionet turistike më të vizituara nga alpinistët e shteteve të ndryshme që nga viti 1975.

Sipas të dhënave gjeografike, radhitet si maja e tretë pas majës së malit Korab dhe Jezercit i cili gjendet në Alpet Shqiptare dhe ka lartësi 2764 metra.

Maja e Gjeravicës i takon territorit të komunës së Junikut dhe thuhet se është njëra nga atraksionet turistike më të vizituara nga alpinistët e shteteve të ndryshme që nga viti 1975.







MALI I ZHLEBIT

LOKACIONI: Deçan

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Ishtrirë mes maleve Hajla dhe Mokna, Zhlebi është pjesë e Bjeshkëve të Nemuna i cili ka dy maja të larta dhe mbresëlënëse. Maja më e lartë në Zhleb është ajo e Rusolisë e cila është 2382 m e lartë, ndërsa maja e poshtme quhet thjeshtë Zhlebi dhe gjendet në 2365 m mbi nivelin e detit.

Ky mal ka një pamje magjepsëse me bjeshkë dhe kodrina të larta e të rrepta.

Nga brenda malit buron lumi Drin i Bardhë duke e shtuar edhe më shumë bukurinë e këtij mali, i cili dhuron qetësi. Ky mal, ashtu si shumë pika të tjera atraktive në Kosovë, tërheqë një numër të lartë turistësh gjatë vitit.





MALI ZHLEBIT



KULLA E MAZREKAJVE

LOKACIONI: Drenoc

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore



Trashëgimia kulturore numëron disa kulla të njohura që i mbijetuan kohës, e padyshim se një e tillë është Kulla e Mazrekajve. Kohës i mbijetoi me dinjitet ndonëse me kalimin e viteve iu desh që të rinovohej. Që nga viti 2004 kur u rinovua, kulla është shndërruar në qendër kulturore. Përveç historisë, kulla tani shërben edhe si lokacion për organizime të ndryshme, filmime, apo qendër e kampeve rinore.

KULLA E MAZREKAJVE





DRESNIK

LOKACIONI: Klinë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Eshtrirë mbi qytetin antik Dardan, duke qëndruar si simbol i historisë, Dresniku është një prej lokaliteteve arkeologjike më të rëndësishme në rajon dhe gërmimet e vazhdueshme kanë rezultuar në zbulimin e qytetërimit të hershëm në Kosovë.

Kjo hapësirë identifikohet me Aulën, e cila i përket pallateve të shekullit III dhe IV. Brenda mureve të gjetura, janë identifikuar edhe komplekse banimi që dëshmojnë nivel të lartë shoqëror, ekonomik dhe artistik të banorëve të asaj kohe.





Pignone



KALAJA E PRIZRENIT

LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

E emërtuar si “Muzeu në qiell të hapur”, Kalaja e Prizrenit është një ndër monumentet më të vlefshme të trashëgimisë tonë kulturore dhe historike. Vendosur në zemër të qytetit, duke u shquar si simbol i qytetit dhe element me rëndësi në identitetin kulturor të Kosovës, kalaja është e pozicionuar në një kodër të lartë, në një ambient pitoresk. Kalaja ngrihet mbi qytet

sikurse edhe mbi luginën e thellë të Lumbardhit dhe rrafshin e Dukagjinit, ndërsa fillet e saja i ka në periudhën e parë të qytetërimit të këtij rajoni, në parahistori.

Sipas studimeve, thuhet se gjurmët e jetës në këtë rajon tregojnë se vendbanimi i parë në qytet daton qysh prej kohës parahistorike, pra nga epoka e bronzit.



Që nga ajo kohë kalaja ende e ruan madhësinë e saj, e ngritur në krye të qytetit. Për nga ndërtimi unik dhe fortifikues, sipas studiuesëve Kalaja e Prizrenit dhuron një pasqyrim të një qyteti të fortifikuar për mbrojtje. Nëse shikojmë kalanë edhe nga poshtë, mund të dallojmë muret e larta dhe me trashësi, që asokohe shërbenin si struktura mbrojtëse. Ashtu si çdo kala tjetër që i ka mbijetuar kohës, edhe Kalaja e Prizrenit, me vete ka bartur histori e gojëdhëna të shumta që i ka shoqëruar njerëzit ndër vite.



KALAJA E PRIZRENIT







SHTËPIA E LIDHJES SË PRIZRENIT

LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Institucion historik/Trashëgimi kulturore

Në qytetin e antikitetit ndodhet një nga shtëpitë që në vete bartë një histori të rëndësishme për trojet shqiptare. Në vitet e para të ndërtimit, ndërtesa e Lidhjes së Prizrenit fillimisht ka shërbyer si mësonjëtoare e kompleksit të Gazi Mehmet Pashës. Kjo ndërtesë është një nga shtyllat më të rëndësishme të historisë shqiptare. Në të është mbajtur një ndër ngjarjet e mëdha historike, krijimi i Lidhjes së Prizrenit në vitin 1878. Për nga ndërtimi, Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit ka stil të thjeshtë por me estetikë të lartë. Sot kjo ndërtesë është e hapur për vizita, dhe tërheqë një atraksion të lartë turistik për të gjithë ata që duan të njihen me historinë e popullit shqiptar dhe betejat historike në të cilat kaluan.



KATEDRALJA E ZONJËS NDIHMËTARE

LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Objekte fetare

Katedralja e Zonjës Ndhimtare në Prizren daton që nga viti 1870 dhe shquhet për stilin e kombinuar arkitekturor gotiko-roman. Mbi altar të Katedralës gjendet figura e Zonjës Ndhimtare, ndërsa për nga vjetërsia, pas kishës së Janjevës është kisha më e vjetër në Kosovë.

Katedralja Katolike e Zojës Ndhimtare u ndërtua nga Dario Bucciarelli, Kryepeshkop i Shkupit, në kohën e Perandorisë Osmane. Në këtë katedrale, përveç afreskeve të shumta me motive fetare, gjendet edhe një afresk e Skënderbeut e realizuar në vitin 1883 nga Gjergj Panariti, një murg dhe piktor shqiptar nga Korça.



XHAMIA BAJRAKLI


LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Objekte fetare

Xhamia e Gazi Mehmet Pashës apo xhamia e Bajrakisë është xhamia qendrore e Prizrenit me 36 xhamitë ekzistuese momentale. Ajo është ngritur në vitin 1573/74 nga Gazi Mehmed Pasha, ushtarak dhe funksionar administrate në shërbim të Perandorisë Osmane.

Për besimtarët myslimanë të Prizrenit, Xhamia e Bajrakisë është e një rëndësie të veçantë. Xhamia e Bajrakisë shtrihet në një sipërfaqe të tërësishme prej 1907m² dhe në të mbahen aktivitete fetare edhe sot. Ky monument i trashëgimisë kulturore paraqet një atraksion turistik për ata që dëshirojnë të vizitojnë bukuritë e Prizrenit.





HAMAMI I PRIZRENIT

LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Objekte fetare

Prizreni është qytet i njohur për trashëgimi kulturore, e në këtë mes i pashmangshëm është edhe Hamami i Gazi Mehmet Pashës. Në bërthamën e qytetit, e vendosur me identitet antik, sot shërben si pikë referimi për të gjithë turistët.

Hamami i Prizrenit ose Hamami i Shemsedin Beut, është ndërtuar në fund të shekullit XV. Sipas të dhënave thuhet se është ndërtuar në vitin 1498, prandaj edhe është në Listën

e Monumenteve të Kosovës. Me kalimin e viteve Hamami i Prizrenit është restauruar dhe ka pësuar ndryshime nga forma bazë. Këto ndryshime shpeshherë janë ndeshur me kritika nga profesionistët e fushës dhe qytetarët.

Madje, ndër vite kishte edhe kritika për mos funksionimin e tij, meqë ky objekt nuk e ka ruajtur destinimin që kishte dhe as nuk i është dhënë ndonjë funksion i ri.



MANASTIRI I ARKANGJELIT TË SHENJTË

LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Objekte fetare

Manastiri i arkangjelit të shenjtë, i njohur edhe si Kisha e Shën Spasit është monument i trashëgimisë kulturore në Prizren i kategorisë "Arkeologjik".

Kisha e Shën Spasit ndodhet në zonën historike të qytetit, respektivisht në pjesën juglindore të Nënkalasë. Në bazë të një burimi shkrimor mendohet se është ndërtuar mes viteve 1333-1335.

Në vitet 1953-63 është bërë konservimi i kishës, ndërsa gjatë viteve 2010 - 2011 nga ana e UNESCO-s është bërë restaurimi i kishës, me ç'rast janë restauruar strukturat e mureve, kulmi dhe enterieri.







URA E GURIT

LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Në rrjedhat e historisë, mbi Lumbardhin e Prizrenit qëndron simboli i qytetit, Ura e Gurit! Burimet historike nuk ofrojnë të dhëna për kohën e saktë të ndërtimit të saj. Në bazë të materialit, stilit, teknikës së ndërtimit, supozohet se ura është ndërtuar nga fundi i shekullit XV, ose në fillim të shekullit XVI. Kjo urë është e vendosur në qendër të qytetit, mbi Lumbardhin që e ndanë qytetin në dy pjesë pothuajse të barabarta. Ura lidh drejtpërsëdrejti sheshin Shadërvan (në anën e majtë të lumit) dhe Saraçhanën (në të djathtë të lumit).



URA E GURIT



MUZEU ETNOLOGJIK I PRIZRENIT

LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Institucion i trashëgimisë kulturore

Prizreni është qytet i trashëgimisë kulturore, lashtësisë dhe traditës! Ndër vite të gjitha traditat e qytetit janë "dokumentuar" në Muzeun Etnologjik të Prizrenit.

Ky muze ka për qëllim promovimin dhe ruajtjen e materialeve etnografike,

veçanërishtë veshjes kombëtare, pastaj, gjësendeve shtëpiake dhe eksponateve me ornamente të caktuara. Muzeu Etnologjik i Prizrenit përmban veshje tradicionale të krahinave të ndryshme të Kosovës si dhe vegla të ndryshme pune, të gjitha ruhen dhe janë të hapura për vizitë nga njerëzit.



SHESHI I SHADËRVANIT

LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Emrin e mori nga shadërvani që qëndron si simbol ikonik në zemër të qytetit, sheshi i Shadërvanit është sheshi qendror në qytetin e Prizrenit! Kjo lagje, e cila është shumë e rëndësishme kulturore dhe shoqërore për prizrenasit, ka pasur një rëndësi të veçantë në çdo periudhë të qytetit. Kjo pjesë e qytetit është një atraksion për turistët ashtu si i tërë qyteti. Sheshi ndër të tjera karakterizohet me dysheme të shtruar në gurë të vegjël të veçantë të periudhës osmane!





SAHAT KULLA

LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Sahat Kulla gjendet në pjesën perëndimore të qytetit të vjetër, fillimisht ishte e ndërtuar me dru, kurse në shekullin e XIX në gjendjen e tanishme, ndërtuar me gurë dhe tulla e ndërtoi Eshref Pashë Rrotulli. Sahat Kulla në Prizren hynë në vazhden e objekteve me orë dhe këmbanë që u sollën në tërë Kosovën, por që nga viti 1912 nga Sahat Kulla u morën ora dhe kambana, dhe sot e asaj dite ato ende mungojnë.

Sipas të dhënave, gjatë viteve të komunizmit Sahat Kulla shfrytëzohej nga banorët e afërt si depo, ahër, e vend mbeturinash, duke e dëmtuar në masë të madhe objektin, gjë e cila ndikoj që objekti të humbas hijeshinë e dikurshme. Sahat Kulla është një ndër objektet më interesante dhe karakteristike të qytetit të Prizrenit. Në vitet e fundit Sahat Kulla është restauruar në një gjendje më të mirë, duke e ruajtur autenticitetin e saj.





MALET E SHARRIT

LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Pasuri natyrore


Injohur si një ndër malet më të larta në Kosovë, Mali i Sharrit është varg malor i shtrirë mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut dhe arrinë lartësi mbi 2700 metra. Vargmali rreth 80 kilometra i gjatë vazhdon në jugperëndim në Malet Korab. Të njohura për rrugë mahnitëse për alpinizëm, Malet e Sharrit kanë përbërje plot diversitet me liqene dhe lumenj, male me ndryshime të vazhdueshme e me kreshta të thepisura. Në anën kosovare gjindet Parku Kombëtar i Sharrit, i cili shtrihet

në një sipërfaqe prej 390 km² ka disa vendpushime sportive dimërore në të dy anët e kufirit. Pjesa e Maleve të Sharrit në Kosovë tashmë është caktuar si park kombëtar dhe pjesa shqiptare është gjithashtu nën mbrojtje. Malet e Sharrit kanë sipërfaqe totale prej 1600 km² 56.25% e kësaj zone ndodhet në Maqedoninë e Veriut, 43.12% në Kosovë dhe 0.63% në Shqipëri. Kodrina malore është rreth 80 km e gjatë dhe 10-20 km e gjerë.









LIQENI I MADH I JAZHINCËS

LOKACIONI: Malet e Sharrit

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Në Bjeshkët e Sharrit është vendosur Liqeni i Madh i Jazhincës me një gjatësi prej 120m dhe gjerësi deri në 80m, me një thellësi të madhe. Ky liqe gjendet në rrenjë të majave Bistra 1 dhe majës së Liqenit.

Për nga përbërja Liqeni i Jazhincës ka ngjyrë të errët të gjelbër në safir dhe është i rrethuar me shkëmbinjë. Liqeni shquhet për temperatura të ulëta, uji është shumë i ftohtë dhe nuk ofron kushte për not.







PREVALLA

LOKACIONI: Prevallë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Prevalla është fshat turistik në jug të Kosovës në Malet e Sharrit, në rrugën e cila shkon nga Prizreni nëpërmjet Prevallës në drejtim të Shtërpcës. Ndër të tjera Prevalla gjendet në kuadër të Parkut Kombëtar Malet e Sharrit dhe ka nivel mbi lartësinë e detit rreth 1800m.

Fshati kufizohet me një pyll të madh, e gjatë verës, është një destinacion i përshtatshëm për rekreacion dhe pushim, ndërsa gjatë dimrit për sportet dimërore sezonale.









UJËVARAT E PREVALLËS

LOKACIONI: Prevallë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Në pyjet mahnitëse të Prevallës qëndrojnë ujëvarat që dhurojnë pamje të mrekullueshme për turistët.







BRODI

LOKACIONI: Dragash


KATEGORIA: Pasuri natyrore

Një ndër fshatrat më të bukur në Kosovë, i cili karakterizohet me një peizazh jashtëzakonisht të bukur dhe mundësi të shkëlqyera për turizmin dimëror.

Fshati Brod ndodhet në komunën e Dragashit dhe për nga terreni është mjaft i larmishëm. Në jugperëndim të Brodit terreni është kodrinor, ndërsa në verilindje është malor. Pika më e lartë mbidetare në këtë vend është 2220 m mbi nivelin e detit, 2.8 km në lindje të fshatit.









RESTELICA

LOKACIONI: Dragash

KATEGORIA: Pasuri natyrore

PRIZREN

Buzë maleve të bukura të Sharrit ndodhet fshati Restelica, ky fshat është i njohur për një pamje magjike. I rrethuar nga malet, lisat e gjatë dhe një freski e përkryer, Restelica dhuron qetësi të pafund!







LIQENI I BREZNËS

LOKACIONI: Opojë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Në jug të Kosovës, në fshatin Breznë është Liqeni i Breznës me një lartësi mbidetare deri në 1000 metra mbi nivelin e detit. Liqeni i Breznës i njohur ndryshe edhe si Liqeni i Opojës është liqeni më i vogël dhe i vetëm natyral në gjithë Kosovën jashtë grupit të liqeneve akullnajore. Për liqenin e Breznës thuhet të ketë ekzistuar qysh në kohërat e vjetra.





MALISHEVA

LOKACIONI: Prizren

KATEGORIA: Qytet

Komuna e Malishevës ndodhet në pjesën qendrore të Kosovës dhe kufizohet me Drenasin në verilindje, Lipjanin në lindje, Suharekën në juglindje, Rahovecin në jug-perëndim dhe Klinën në veri-perëndim.

Malisheva ka gjithsej 43 fshatra dhe sipas të dhënave thuhet se zona e përgjithshme ka një sipërfaqe prej 361 km².



Ferizaj





MUZEU I FERIZAJT

LOKACIONI: Ferizaj


KATEGORIA: Institucion i trashëgimisë kulturore

Muzeu i Ferizajt është institucion që ruan dhe promovon trashëgiminë kulturore të Ferizajt, e cila shquhet si më të pasurat në Kosovë. Ky institucion kulturor është themeluar me vendim të Kuvendit Komunal të Ferizajt, më datë 2 qershor 2011, dhe është i pasur me artefakte arkeologjike, etnologjike dhe historike.

Ndonëse muzeu vepron në një hapësirë relativisht të vogël, tërësia që gjendet brenda objektit është e rregulluar dhe sistemuar mjaft mirë me mbi 1000 eksponate të ndryshme që e karakterizojnë punën e muzeut si institucion i cili ruan promovon dhe prezanton vlerat e trashëgimisë kulturore të popullatës së Ferizajt.



FERIZAJ





TEATRI "ADRIANA"

LOKACIONI: Ferizaj

KATEGORIA: Institucion kulturor

Qyteti i Ferizajt njihet për traditën e artit për shumë vite me radhë, e padyshim që është një vend i rëndësishëm në fushën e artit. Në këtë traditë zë vend edhe teatri.

Shtëpia nga e cila dolën shumë artistë të shquar, teatri i qytetit të Ferizajt "Adriana Abdullahu" është institucion kulturor, veprimtaria e të cilit zë fill që nga viti 1943, ku sipas shënimeve të themeluesit të teatrit mendohet të ketë qenë Hasan Dyngjeri.

Deri më sot në këtë teatër janë dhënë mbi 140 premiera, të gjitha duke shtjelluar tematika të ndryshme, ngjarje reale e joreale.



BIFURKACIONI NË LUMIN NERODIME

LOKACIONI: Ferizaj

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Ndarja e lumit në dy degë dhe derdhja në ujëmbledhës të ndryshëm detar quhet bifurkacion. Një fenomen i tillë haset në lumin e Nerodimes në Ferizaj. Lumi i Nerodimës buron në Bjeshkët e Jezercit, në afërsi të Ferizajt dhe ndahet në dy degë, të cilat kanë derdhje në dy dete të ndryshme.

Dega veriore (dega e majtë) derdhet në lumin Sitnicë dhe vazhdon rrugëtimin në lumin Ibër, Moravë dhe përmes Danubit derdhet në Detin e Zi. Ndërsa dega jugore (dega e djathtë) përmes lumit Lepenc dhe Vardarit derdhet në Detin Egje. Bifurkacioni i lumit Nerodime nga viti 1979 është vënë nën mbrojtje ligjore si rezervat special i natyrës.



FERIZAJ





BIFURKACIONI NË LUMIN NERODIME



MALET E LUBOTENIT

LOKACIONI: Kaçanik

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Epozicionuar në malet e Sharrit me 2498 metra lartësi, Maja e Lubotenit ndodhet në pjesën perëndimore të Kaçanikut. Luboteni paraqet një vend pitoresk të Sharrit i cili ofron mundësi për zhvillimin e turizmit malor gjatë çdo stine të vitit. Luboteni konsiderohet si maja më e bukur e maleve të Sharrit dhe ofron peizazhe mahnitëse për vizitorët. Shquhet si një ndër vendet më të

bukura për tu vizituar në Kosovë, me male dhe shpate të larta e të rrepta! Edhe pse shquhet si majë e vështirë për tu arritur, numri i vizitorëve të kësaj maje është i lartë dhe frekuentohet kryesisht nga alpinistët, të cilët e zgjedhin për ta sfiduar veten.









JEZERCË

LOKACIONI: Ferizaj

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Fshati Jezercë përfshin një nga hapësirat më të mëdha gjeografike në komunën e Ferizajt dhe gjendet në pjesën lindore të kësaj komune. Që nga viti 1999 njihet me emrat Bjeshkas dhe Kushtrim. Bazuar në hulumtimet vonë të realizuara, thuhet se Jezerca është një fshat i banuar qysh nga koha iliro-romake.

Në periudha të ndryshme kohore, banorët e fshatit kanë migruar në qytet, gjë që ka ndikuar në infrastrukturën e dobët që ka fshati, megjithatë njihet si çerdhe veprimtarësh atdhetarë për çështjen kombëtare-liridashëse.



FERIZAJ





BREZOVICA

LOKACIONI: Shtërpca
KATEGORIA: Pasuri natyrore

Enjuhur si "Perla e Ballkanit", me lartësi mbidetare nga 1718-2522 m, Brezovica është një nga destinacionet turistike dimërore më të vizituara në Kosovë. Vija e kreshtës përfshinë 39 mijë hektarë terren dhe pyje të larta malore alpine, në shpatet veriore dhe veriperëndimore të Parkut Kombëtar Sharr.

Brezovica është ndër lokacionet më të vizituara turistike dimërore në Kosovë. Zona turistike e skijimit ndodhet në pozi-

cion ideal në shpatet e Parkut Kombëtar të Sharrit në veri dhe në veriperëndim. Linja e kreshtës përfshinë 39,000 hektarë terren malor alpin dhe pyje, me florë dhe faunë të larmishme dhe të bollshme.

Qendra e skijimit "Brezovica" është e hapur për adhuruesit e skijimit gjatë të gjitha stinëve të vitit, ku në verë, sipërfaqja e mbuluar me borë zvogëlohet por prapë lë mundësinë e shfrytëzimit.









KAÇANIKU

LOKACIONI: Ferizaj

KATEGORIA: Qytet

Kaçaniku është qytet i vogël në jug të Kosovës dhe ka një sipërfaqe prej 306 km katrorë, i përbërë nga 31 vendbanime, një me karakter urban dhe 30 rural. Kaçaniku si qendër administrative – qytezë daton që nga fundi i shekullit XVI dhe dallohet për kushte të volitshme topografike dhe klimatike.

Në Kaçanik kalon lumi Lepenc dhe Nerodime, kurse për nga karakteri kjo qytezë është kryesisht vend industrial, mirëpo ekzistojnë kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, zejtarisë e në veçanti kushte të mira për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv, veror, malor dhe transit.







Agilan





KALAJA E POGRAGJËS

LOKACIONI: Gjilan

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

10 kilometra larg nga juglindja e Gjilanit, pozicionohet një nga monumentet më të rëndësishme historiko-kulturore të Kosovës, Kalaja e Pogragjës. Me një lartësi mbidetare prej 567 m në grykën e Llapushnicës, Kalaja e Pogragjës është një monument shumë i vjetër, dhe si çdo monument i trojeve tona, është e mbushur me histori e gojëdhëna të cilat i kanë mbijetuar kohës.

Në kala gjendet i ashtuquajtur "Guri i Qumështit", i cili në popull njihet si gurë shërues. Po ashtu, nga gojëdhënat e trashëguara thuhet se brenda kalasë qëndrojnë muret e një qyteti që ekzistonte vite më parë.

Edhe fshati Pogragjë e ka marrë emrin sipas kësaj kalaje, e cila për nga ndërtimi ka mure të trasha prej gurve të cilët janë të forcuar me gëlqere. Thuhet se gjatë ndërtimit, këta gurë janë sjellur nga lumi i Moravës së Binçit, dhe janë bartur dorë me dorë në majë të Kalasë.

Kodra në të cilën gjendet Kalaja e Pogragjës, është vendkalim i rrjedhës së lumenjëve Moravë e Binçit dhe Llapushnik.



GJILAN







TEATRI I GJILANIT

LOKACIONI: Gjiilan

KATEGORIA: Institucion i trashëgimisë kulturore

Teatrit i Gjiilanit, sipas të dhënave në dokumentet e shkruara dhe të deklaruar, daton që nga 26 marsi i vitit 1944. Shfaqja e parë llogaritet të ketë qenë, komedia “Vllazni e interes” e autorit Kristo Floqi. Ky teatër është shtëpia e shumë artistëve të njohur, vendi nga i cili dolën yje të skenës.

Ky teatër rikoncepton e rikonfiguron funksionimin e tij artistik e menaxherial. Ndërsakakrijuar për herë të parë repertorin e qëndrueshem artistik; kalendarin mujor të shfaqjeve; Teatrin Magjik të Fëmijëve, ka zgjidhur përfundimisht statusin e tij financiar e juridik, ka krijuar ansamblin e rikonfiguruar dhe ka mundësuar nënshkrimin e kontratave të rregullta me stafin artistik dhe teknik. Të gjitha këto kanë mundësuar fillimin e historisë së re të këtij institucioni kulturor.



PARKU I QYTETIT

LOKACIONI: Gjiilan

KATEGORIA: Hapësirë e mbrojtur nga shteti

Në pjesën jugperëndimore të Gjiilanit ndodhet i ashtuquajti Parku i Epërm apo Parku i Madh i Qytetit, vendosur skaj hapësirës e cila njihet si “Kombinati i Duhanit”.

Ndër vite kjo pjesë e qytetit ka qenë mjaft e vizituar, pasi ofronte një peizazh me dushk e bagrem, e rrugicë në mes për shëtitje. Tani në këtë hapësirë ndodhet Parku i fëmijëve dhe shëtitorja në jug.



SAHAT KULLA

LOKACIONI: Gjiilan

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Për vite me radhë, Gjiilani u identifikua me Sahatkullën, madje ishte një ndër objektet publike më karakteristike të trashëgimisë arkitektonike kulturore të Gjiilanit. Për këtë objekt mungojnë të dhënat e nevojshme sidomos ato më të hershme, si viti i ndërtimit.

E vetmja e dhënë e cila mendohet të jetë e saktë, thotë se Sahatkulla është ndërtuar nga Bahti bej Gjinolli, menjëherë pas vendosjes në Gjiilan si kullë mbrojtëse për t'u shndërruar më vonë në Sahat Kullë!





TEQJA E GJILANIT

LOKACIONI: Gjilan

KATEGORIA: Objekte fetare

Teqja në Gjilan sipas të dhënave, (mauzole), e rrethuar me mure, por jo është ndërtuar më 1881 nga edhe e mbuluar. Në tyrbe gjenden 4 Sheh Islami, muhaxhir i ardhur varre ku janë varrosur shehlerët. Kjo nga Leskoci bashkë me banorët teqe gjendet në varësi të teqesë së muhaxhirë shqiptarë dhe ndodhej në Nesalcës. Teqja është djegur pas luftës periferi të Gjilanit, në veri të Lagjes së fundit në Kosovë, në rrethana të së Muhaxhirëve. Pranë teqes gjendej panjohura, dhe prapë është rindërtuar edhe tyrbja, si monument mbivarror nga Ministria e Kulturës.





ATIK XHAMIA

LOKACIONI: Gjilan

KATEGORIA: Objekte fetare

Enjuhur edhe si Xhamia e Medresesë, Atik Xhamia është objekti i parë i kultit fetar islam i këtij lloji i ndërtuar në qytetin e Gjilanit. Viti i saktë i ndërtimit të xhamisë nuk dihet por mendohet që u ndërtua në shekullin XVII.

Duke qenë kaq e rëndësishme dhe e

vjetër, Atik Xhamia është e listuar si monument i trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe është nën mbrojtje të përkohshme që nga viti 2012! Në oborr të xhamisë ndodhej shatërvani si dhe objekti ku laheshin kufomat. Mirëpo, tani vendin e tyre e kanë zënë ndërtesat përcjellëse, lokalet dhe medreseja!





MUZEU I QYTETIT TË GJILANIT

LOKACIONI: Gjiilan

KATEGORIA: Institucion i trashëgimisë kulturore

Muzeu i qytetit të Gjiilanit është monument i trashëgimisë kulturore i kategorisë "Arkitekturor". Bazuar në të dhëna, ky objekt është ndërtuar në gjysmën e shek. XIX. Në vitet e para të funksionimit ka shërbyer për banim ndërsa më vonë u shfrytëzua si ndërtesë administrative për nevojat e zyrtarëve komunal. Madje në periudhën e viteve 1944/45, mbrapa objektit ndodheshin dhoma, të cilat në mungesë të burgjeve të mjaftueshme, janë përdorur për burgosjen e shqiptarëve. E pas luftës së fundit, një kohë, në këtë objekt ka vepruar logjistika e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Trupave Mbrojtëse të Kosovës të Zonës Operative të Karadakut. Në vitin 2015, ky objekt iu dedikua muzeut të Gjiilanit. Sot ky muze shërben për grumbullimin e artefakteve historike dhe kulturore të Gjiilanit, si një memoar për kujtesën e popullit!



GJILAN



LIQENI I PËRLEPNICËS

LOKACIONI: Gjilan

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Në malet mahnitëse të Gollakut pozicionohet një liqe i vogël por mjaft tërheqës, Liqeni i Përlepticës. Ky liqe i vogël ndodhet në pjesën perëndimore të Kosovës, pra në Malet e Gollakut në veri-lindje të qytetit të Gjilanit nga i cili qyteti edhe furnizohet me ujë. Ndër të tjera edhe një degë e Moravës së Binçës rrjedh nëpër Liqenin e Përlepticës.





LIQENI I LIVOQIT

LOKACIONI: Gjiilan

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Në Gjiilan ndodhet liqeni artificial i Livoqit, ky liqe i vogël shtrihet në perëndim të qytetit të Gjiilanit dhe afër Maleve të Gollakut. Liqeni furnizohet me ujë nga një degë e vogël Moravës së Bincës. Sipas të dhënave thuhet se është liqeni i dytë për nga madhësia, në lindje të Kosovës, pas Liqenit të Përlepticës.





KALAJA E ARTANËS

LOKACIONI: Artanë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Evendosur rreth 30-35 km në perëndim prej Gjilanit dhe rreth 39 kilometra në jug-lindje të Prishtinës, Kalaja e Artanës është monument kulturor ku ruhen rrënojat e qytetit dhe fortesës mesjetare. Ndër vite, ky vend është shquar si burim i xeheve, por në rrethinat e kalasë janë nxjerrë minerale të ndryshme të arit dhe argjendit.

Mendohet se është një ndër vendbanimet më të hershme në rrethinën e Prishtinës, strukturat e para të së cilës janë ngritur nga aktivitetet e hershme minerare.

Kalaja është ndërtuar në një kodrinë shumë strategjike në formë të tipit fortifikatë dhe përbëhet nga dy pjesë. Sipas studimeve thuhet se është e ndarë në Kalanë e sipërme e quajtur "Citadela" dhe atë të poshtmen. Kalaja e sipërme është ndërtuar në pjesën më të lartë të kodrës ndërsa ajo e poshtme shtrihet në kodra më të ulëta, në lindje dhe juglindje, deri te miniera nën Malin e Madh.







KAMENICA

LOKACIONI: Gjilan

KATEGORIA: Qytet



Vendosur në pjesën lindore të Kosovës, e mbushur plot trashëgimi, kulturë dhe pasuri natyrore, ndodhet qyteti i Kamenicës i njohur edhe me emrin Dardanë.

Në veri Kamenica kufizohet me Medvegjën, në veri-lindje me Leskovcin ndërsa në jug-perëndim të Dardanës gjendet Gjilani dhe pjesën veri-perëndimore gjendet Prishtina. Kamenica ka 36.000 banorë të shpërndarë në qytet dhe 57 fshatra, në të cilat gjinden disa nga vendet më të bukura të Kosovës, disa nga historitë e dëgjuara, mitet e thurura e kalatë që ende qëndrojnë plot dinjitet.









MANASTIRI I MOÇARIT

LOKACIONI: Kamenicë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Një nga monumentet më të rëndësishme dhe patjetër edhe ekspozues për vetë Kosovën, për vlerat arkitekturore, si dhe rrënojë për shekuj me radhë, mbetet Manastiri i Moçarit komuna e Dardanës/ Kamenicës. Ky manastir ruhet si trashëgimi kulturore jo vetëm për shkak të arkitekturës së fortë të punuar me gurë, por edhe historisë shekullore.





UJËVARA E HOGOSHTIT

LOKACIONI: Kamenicë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Kamenica gëzon shumë atraksione tërheqëse për zhvillimin e turizmit. Destinacioni i saj turistik ka potencial të mrekullueshëm natyror. Për shkak të pozitës së shkëlqyer gjeografike, Kamenica është mjaft interesante me bukuritë e ndërtuara nga vetë natyra.

Ujëvara e Hogoshtit, e njohur edhe si ujëvara e Qurrelit, gjendet në fshatin Hogosht, 13 km larg qendrës së Kamenicës. Ujëvara ndodhet rrëzë maleve të Hogoshtit, me dy rrjedha të veçanta uji që burojnë nga shkëmbinjtë dhe e bëjnë këtë vend të jashtëzakonshëm me atraksione natyrore.



Gjakova





URA E TERZIVE

LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Evendosur 7 km larg qytetit të Gjakovës, mbilumin Erenik dhe pranë fshatit Bishtazhin, Ura e Terzive përçjellë vlera të historisë dhe arkitekturës. Sipas të dhënave nga historia thuhet se Ura e Terzive u ndërtua nga Esnafët (tregtarët) e Terzive të Gjakovës të cilët ishin rrobaqepës dhe asokohe njiheshin si “terzitë”. Ura ka 11 harqe të madhësive të ndryshme, dhe është 193 m e gjatë dhe 5 m e gjërë.

Për sa i përket ndërtimit, ura mund të quhet fenomen pasi që në kohë kur u ndërtua nuk kishte as paisje

teknologjike e as inxhinierë me përvojë rreth ndërtimit të urave.

Nuk dihet saktësisht se kur është ndërtuar, por supozohet të ketë ndodhur në fund të shekullit të 15-të. Sipas të dhënave, këtë mendim e mbështetë edhe fakti që ura ishte ngritur në një rrugë mesjetare, e cila e lidhë Gjakovën me Prizrenin, dhe që më vonë u zgjerua për shkak të ndryshimeve të rrjedhës së lumit Erenik. Në shekullin e 18-të ura kishte ndryshime të mëdha, pas luftërave dhe ndryshimeve klimatike të cilat i dhanë pamjen aktuale që ka këto ditë.







URA E FSHAJTË

LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Në fund të kanionit të Drinit të Bardhë ndodhet Ura e Fshajtë në fshatin Fshajtë të Përdrinisë, në komunën e Gjakovës. Ura e Fshajtë njihet si monument i trashëgimisë kulturore, ndërsa pjesa përreth saj dhe kanionit është shpallur zonë e mbrojtur natyrore e karakterit hidro-gjeomorfologjik.

Sipas gojëdhënave thuhet se ekzistimi i Urës së Fshajtë lidhet me legjendën e flijimit të gruas në themelet e kështjellës dhe të urës.

Ura njihet edhe me emra tjerë, si “Ura e Shejtë”, “Ura e Shejtit”, “Ura e Rozafës”. Sipas gojëdhënave, emërtimin “e fshajtë” apo “e fshejtë”, ekamarrë sipas ofshamave të gruas gjatë murimit.

Sot kjo urë ka një përdorim të gjërë si urë për kërcimet tradicionale e spektakolare në Lumin Drini i Bardhë, nga 22 metra lartësi, aktivitet që përcillet e shikohet nga mijëra njerëz.



GJAKOVË





SHPELLA E KUSARIT

LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Shpella e Kusarit gjendet vetëm 1 km larg fshatit Kusar dhe shquhet për lashtësinë dhe karakteristikat shkëmbore të shkallëzuara, që mundësojnë ecjen e vizitorëve që duan të hulumtojnë brendësitë e kësaj shpelle.

Ekzistenca e saj thuhet të jetë e lashtë, e si e tillë padyshim që paraqet një vend mjaft tërheqës për tu vizituar.

Me gjithsej tri hyrje, në këtë shpellë mendohet se mund të zbulohen edhe hyrje të tjera. Vetëm disa metra në lindje të Shpellës së Kusarit ndodhet Shpella e Qirave e cila bashkë me të parën, përbëjnë një atraksion më vete.





ÇARSHIA E MADHE

LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Dikur pikëqendër e zhvillimit ekonomik, ndërsa sot njihet si krenari e trashëgimisë kulturore në Gjakovë. Çarshia e Madhe shumë vite më parë ishte vendi ku shiteshin mallrat për banorët e qytetit dhe fshatrave përreth komunës së Gjakovës. Për këtë arsye vendi ka marrë emrin qyteti i tregtisë.



Prugët e gjata të shtruara me gurë të Çarshisë së Madhe në Gjakovë numërojnë rreth 500 dyqane të vogla prej druri, një bukuri më të cilën shquhet qyteti. Këto dyqane që prej shekullit XVI kanë qenë qendra të zejtarëve të ndryshëm. Çarshia e Madhe është atraksion për turistët por edhe për banorët e zonës të cilët kalojnë kohë në këto hapësira.

ÇARSHIA E MADHE





KODRA E ÇABRATIT

LOKACIONI: Gjakovë
KATEGORIA: Pasuri natyrore

Kodra e Çabratit gjendet në qytetin e Gjakovës vetëm 10km larg nga Qendra. Njihet si vend ideal për klimë të freskët dhe pamje mahnitëse nga ku mund të shihet si në pëllëmbë të dorës i tërë qyteti i Gjakovës.



PARKU I SHKUGZËS


LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Ipozicionuar në pjesën jugore të qytetit të Gjakovës, Parku i Shkugzës njihet për vlerat e biodiversitetit dhe peisazhit, ku shtrihet mes dy kodrave të ndara nga lumi i vogël Shlepica, në lartësi mbidetare prej 410-460 m.







XHAMIA E HADUMIT


LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Objekte fetare

Gjakova është qytet i kulturës, traditës, zakoneve dhe historive të lashta qytetare të cilat i mbijetuan kohës.

Në zemër të qytetit ndodhet një nga monumentet e trashëgimisë kulturore i njohur si Kompleksi Xhamia e Hadumit, i listuar si monument i kategorisë "arkitekturor". I gjithë objekti i Xhamisë së Hadumit ka estetikë unike falë arkitekturës dhe zbukurimeve të shumta murale, drunjëve selvijë, peizazheve natyrore, pjesëve florale dhe figurave gjeometrike.





SAHAT KULLA

LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Trashëgimi kulturore

Ky objekt ishte ndërtuar në vitin 1597 në periudhën osmane të cilat janë simbole të zhvillimit të qytetit. Sipas të dhënave nga historia, Sahat Kulla ka pasur edhe një këmbanë që bashkë me orën informoi qytetarët për kohën e mbajtjes së pazarit në qytet. Më pas këmbanën e kanë vjedhur. Kulla e sahatit përreth saj ka edhe një sërë

objektsh të tjera të cilat datojnë pak më vonë se kulla, gjë që e bën kullën të jetë ndër objektet e para të ndërtimit. Kulla, sot për sot ka një orë tjetër e cila funksionon dhe tregon orën e Saktë. Poashtu është një atraksion i vërtetë, pasi nga pjesa e sipërme e kullës mund ta vëzhgosh një pjesë të madhe të qytetit.



MUZEU ETNOGRAFIK I GJAKOVËS

LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Institucion i trashëgimisë kulturore

Muzeu Etnografik i Gjakovës është njëri nga objektet më të veçanta që bartë shumë histori më vete. Ai përfaqëson një vendbanim tipik urban të ndërtuar në vitin 1830, i vendosur në një shtëpi tradicionale. Fillimisht, ndërtesa i përkiste familjes gjakovare Sina dhe më vonë u ble nga familja Haxhismaili. Në vitin 1981 ishte marrë nga kjo familje në pronësi të Kuvendit Komunal për ta shndërruar atë në Muze Etnografik. Ndërtesa ka dy kate, dy garnitura dhe ka një koleksion të pasur, duke shfaqur historinë dhe kulturën lokale. Muzeu i Gjakovës është njëri prej muzeve më të pasur në Kosovë dhe në Ballkan sa i përket eksponateve.





TEQEJA BEKTASHIANE

LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Objekte fetare

Ethemeluar në vitin 1790 deri tani në këtë Teqe kanë shërbyer 12 baballarë, duke i shërbyer jo vetëm fesë por edhe kombit. Sipas të dhënave historike Teqeja Bektashiane e Gjakovës ka qenë vatër e arsimit shqip ndër breza dhe qendër nxitëse e arsimit të vajzave. Po ashtu, Teqeja ka ndikuar në zhvillimin e kulturës që nga vitet e 90' kur edhe u shndërrua në shkollë shqipe dhe Qendër Kulturore.







LUMI KRENA

LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Lumi Krena është degë e lumit të Erenikut. Shtrihet në pjesën jugperëndimore të Rrafshit të Dukagjinit me një gjatësi rreth 23 km.

Lumi buron te vendi i quajtur Krojet e Hasan Agës, në Bjeshkët e Vokshit dhe rrjedh në drejtim të Rrafshit të Dukagjinit, duke kaluar nëpër qytetin e Gjakovës, e në afërsi të Spitalit të Gjakovës lumi Krena derdhet në Erenik.



LUMI I ERENIKUT

LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Ereniku është lum në pjesën perëndimore të Kosovës, i cili ka dy Degë. Njëra buron te Bjeshka Rrasa e Zogut dhe dega tjetër buron te Bjeshkët e Junikut pranë Gjeravicës dhe derdhet në lumin Drini i Bardhë, kurse në lindje tek Ura e Terezinjëve. Sipas të dhënave thuhet se Ereniku është më shumë lum fushor meqë dy e treta e rrjedhës kalon nëpër pjesë të ulët të fushës, e cila ka lartësi në mes 300 e 500 m. Sistemin hidrografik të Erenikut e përbëjnë 80 rrjedha ujore, të cilat e begatojnë këtë sistem me sasi më të madhe të ujit.



RADONIQI

LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Liqeni i Radoniqit është liqen artificial në Gjakovë i krijuar në vitet e 80-ta. Ky liqe, emrin e mori nga fshati i cili u përmbys për krijimin e tij, fshat i cili shtrihet në shtratin e këtij liqeni. Radoniqi furnizon me ujë rreth 214.000 banorë të qyteteve të Gjakovës dhe Rahovecit si dhe fshatrave përreth, e po ashtu përdoret për ujitjen e 10,500 ha tokë. Me një sipërfaqe prej 5.62 km², Radoniqi zë vendin e dytë në Kosovë për nga sipërfaqja.

DUSHKAJA

LOKACIONI: Gjakovë

KATEGORIA: Pasuri natyrore



Dushkaja shtrihet në 229 km² të Rrafshit të Dukagjinit, i përbërë nga 28 fshatra. Dushkaja përfshinë hapësirën mes Lumbardhit të Deçanit në veri deri te rrjedha e mesme e lumit Erenik, në jugperëndim.

Karakteristika kryesore e Dushkajës është pylli, në të cilin mbizotëron druri i dushkut, nga edhe ka marrë emrin dushkajë. Në strukturën e tokave, pyjet paraqesin elementin kryesor të peisazhit me afro 45%, kurse elementi i dytë identifikues janë arat dhe kopshtet, livadhet dhe kullotat që e bëjnë Dushkajën të shquhet si mjedis agraro-blegtoral.





JUNIKU

LOKACIONI: Junik

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Në Kosovën perëndimore ndodhet një qytet i vogël por me një traditë të madhe. Juniku ndodhet në mes të Deçanit dhe Gjakovës, përgjatë kufirit malor të Kosovës me Shqipërinë, ky vend njihet si vendlindja e disa njerëzve të shquar, të cilët kanë bërë histori.



Sipas të dhënave, mbi Junik gjendet një vend që quhet Gradina, ku mendohet se ishte i banuar që nga koha Ilire. Poashtu një veçanti e Junikut është se ky qytet është i vetmi në trojet shqiptare ku jetonin 12 fise shqiptare, tani jetojnë 10 prej tyre.





VRESHTAT E RAHOVECIT

LOKACIONI: Rahovec

KATEGORIA: Pasuri natyrore



Vreshtat janë një lidhje e ngushtë me emrin Rahovec, e kjo pasi tradita e vjetër dhe e bukur e qytetarëve të Rahovecit ruhet ende me një dashuri dhe përkushtim të madh.

Sipas të dhënave komuna e Rahovecit, qyteti dhe 36 fshatrat, kapin shifrën e një hapësire prej 1000 ha vreshtë. Prodhimi i verës dhe rakisë është një proces mjaft delikatë, por të cilin qytetarët e Rahovecit tashmë e prodhojnë me një kualitet dhe profesionalizëm të lartë!



VRESHTAT E RAHOVECIT





KRUSHA E MADHE

LOKACIONI: Rahovec

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Në qytetin e Rahovecit ndodhet fshati Krushë e Madhe. Ky fshat është i njohur për peizazhin e magjishëm, me kodra dhe livadhe të gjera e florë të pasur. Ka mbi 6000 banorë dhe gjindet në magjistralen Prizren-Gjakovë. Si fshat karakterizohet me kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore.







UJËVARAT E MIRUSHËS

LOKACIONI: Klinë

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Të pozicionuara në fshatin Llapçevë të komunës së Malishevës, Ujëvarat e Mirushës janë pjesë e një parku me rëndësi të veçantë natyrore, shkencore, kulturore dhe turistike.

Përveç bukurisë dhe rëndësisë turistike, lumi Mirusha gjatë rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanioni i lumit Mirusha dhe krijon 12 ujëvara dhe 16 liqene që paraqesin një fenomen të rrallë morfo hidrologjik.

Kanioni i Mirushës është një ndër zonat më interesante të natyrës së Kosovës, ndërkaq lumi Mirusha në pjesën e poshtme të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanioni i lumit Mirushë. Në këtë pjesë të kanionit gjenden 16 ujëvara me liqene që e përbëjnë pjesën më tërheqëse të kësaj zone për turizëm!

Në vitin 2012, Qeveria e Kosovës e ka shpallur Ujëvarën e Mirushës Monument Natyror me rëndësi të veçantë.

FUSHAT E LULEDIELLIT

KATEGORIA: Pasuri natyrore



Stina e verës është e magjishme me fushat e mbjella me luledielli të cilat dhurojnë pamje mahnitëse në çdo zonë të vendit.

Në fushat bujqësore të Kosovës kultivohen dhe prodhohen farërat e vajrave, traditë kjo e ruajtur brez pas brezi.



FUSHAT E GRURIT

KATEGORIA: Pasuri natyrore

Tradita e kultivimit të grurit është traditë e ruajtur me krenari dhe e trashëguar brez pas brezi. Gruri rritet më shumë se çdo kulturë tjetër dhe tregtia botërore me grurë është më e madhe se të gjitha kulturat e tjera të kombinuara. Në Kosovë, gruri kultivohet në një sasi shumë të madhe e tokat e pjellshme të mbjellura me grurë mund të hasen në shumë qytete, duke rritur jo vetëm profitin vendit por edhe bukurinë e këtyre zonave.



Aut i vugës





NEWBORN

LOKACIONI: Prishtinë

KATEGORIA: Art i rrugës

Skulptura tipografike “NEWBORN” është një nga atraksionet më të veçanta turistike në kryeqytetin e Kosovës. Vendosur përballë Pallatit të Rinisë dhe Sporteve, ky monument shënon shpalljen e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Për çdo përvjetor të ditës së pavarësisë, përmes këtij monumenti ngriten qështje të ndryshme sociale e politike. Duke qëndruar si simbol i pavarësisë së shtetit dhe tashmë ikonë e Prishtinës, skulptura “NEWBORN” është një ndër pikat më tërheqëse për turistët.





MURALET, ARTI I RRUGËS

LOKACIONI: Prishtinë
KATEGORIA: Arti i rrugës

Muralet janë më shumë se vetëm pikturime, teksa bartin mesazh dhe shpesh edhe histori, e përgjatë viteve të fundit, Kosova është bërë pikë referuese për artin e rrugës nga të gjitha anët e botës. Tani tradicionale, festivalet e shumta të artit të grafitit mbledhin në Kosovë artistë nga vende të ndryshme. Kryeqyteti i larmishëm, Prishtina dhe

qyteti i Ferizajt, dallohen me murale që trajtojnë tematika e qështje të ndryshme; tema që kanë të bëjnë me histori nga jeta e kosovarëve, tematika të barazisë gjinore, të drejtave të fëmijëve e deri tek murale që kanë të bëjnë me histori personale të plotë njerëzve të vendit.





"1637 – IT'S NOT JUST A NUMBER"

LOKACIONI: Ferizaj

KATEGORIA: Art i rrugës

Muralet ndër vite kanë qenë përfaqësues i denjë i rikujtimit të ngjarjeve në vend. Ky mural i vendosur në Ferizaj i përkushtohet personave të pagjetur dhe familjeve të tyre që humbën të dashurit e tyre gjatë luftës së fundit në Kosovë. Sipas të dhënave statistikore në Kosovë janë 1639 persona të pagjetur. Ky mural është më shumë se një pikturë, përmes kësaj pasqyre me ngjyra shpërfaqet rëndësia e artit, shpalosja e historisë përmes muraleve, përmes artit të rrugës, duke siguruar që historia të mos harrohet asnjëherë!



Fauna





ARIU I MURRMË

KATEGORIA: Faunë

Ariu i murrmë është specie nga Faunë dhe njihet si një nga anëtarët më të mëdhenjë tokësorë të rendit Karnivora. Ariu i murrmë njihet si një kafshë kombëtare dhe shtetërore në disa vende evropiane.

Kjo specie e mbuluar me gëzof të kaftë të murrmë haset edhe në trojet tona, mund të peshoj nga 100 deri në 700 kg, mbi supet kanë një gungë të madhe. Kthetrat e ariut të murrmë janë të gjata deti 15 cm të cilat nuk tërheqen dhe arinjtë më së shumti i përdorin ato për gjermime.





SHQIPONJAT

KATEGORIA: Faunë



Grabitqarja e trojeve shqiptare, shpend i bukur dhe misterioz, karakterizohet me sqep të fuqishëm dhe shikim të mprehtë. E njohur si simbol i vjetër i shqiptarëve, duke u vendosur si stemë në flamur e në shumë zbukurime, shqiponja ëshë shpend të cilit shqiptarët i kanë veshur shumë virtyte. Për shqiptarët, përveçse simbol i kombit, ajo përfaqëson identitetin e trojeve të banuara prej tyre ndër shekuj. Shqiponjat janë zogj të mëdhenj nga 500 gr deri në 9 kg dhe si rojtarë, ato patrollojnë qiejt e pastër mbi dhe përtej majave shkëmbore larg dhe gjerë. Shqiponja e malit është shpend madhështor, tipik i zonave malore dhe me aftësi të mëdha fluturuese, e nga lartësia i dallohen vetëm qafa, krahët dhe bishti i gjatë e unik.



SHQIPONJA BUTEO – BUTEO

KATEGORIA: Faunë

Në viset tona, më saktë mbi Liqenin e Badovcit është hasur një shqiponjë mjaft karakteristike dhe e veçantë. E njohur me emrin shqiponja Buteo Buteo apo edhe shqiponja minjëngrënëse, kjo shqiponjë ushqehet me minjë dhe zvarranikë dhe shquhen si pastruesit më të mëdhenj të terrenit.





DHIA E EGËR

KATEGORIA: Faunë

Enjuhur si “Mbretëresha e Kafshëve Shqiptare”, dhia e egër është kafshë unike jo vetëm për nga pamja por edhe për jetesën e saj në vende të thekta malore. Është kafshë gjitare barngrënëse, ripërtpëse, me brirë të gjatë të ngritur pingul mbi kokë. Në viset shqiptare haset në të gjitha zonat shkëmbore alpine, shpesh edhe në gërxhe të thepisura dhe jeton rreth 25 vjet.

Jetesa e dhisë së egër është kryesisht në bashkësi kopeshë të cilat përbëhen nga 15 deri në 30 krerë. Ndonëse me trup nuk janë të mëdha, shquhen si kafshë shumë të shpejta pasi që kanë thundra të posaqme për ecje dhe vrapim, gjë që ju mundëson përforcim nëpër shkëmbinj, qofshin ata edhe të rrëshqitshëm. Dhia e egër është e listuar si kafshë në zhdukje dhe mbrohet nga shteti.







LEJLEKU I ZI

KATEGORIA: Faunë



Krejtësisht i zi dhe me shkëlqim në pjesën e sipërme të trupit, lejleku i zi është një ndër kafshët me të cilat Kosova prezanton faunën. Përgjatë historisë, vende e kultura të ndryshme, e kanë mbrojtur këtë lejlek me ligje të veçanta dhe tepër të ashpra. Për nga madhësia e trupit është pak më i vogël se lejleku i bardhë, pesha mesatare e tij është rreth 3 kg dhe gjatësia 95 cm.

Ky lloj folenë e ndërton sipas mundësive që i ofron habitatit, ndërsa sipas studimeve ky shpend haset në vende liqenore, në juglindje, por nganjëherë edhe në zona urbane. Lejleku i zi shihet në vendin tonë kryesisht gjatë periudhës së shtegëtimit.





KAPROLLI I PYJEVE SHQIPTARE

KATEGORIA: Faunë

Kaprolli është një nga kafshët më të bukura malore në vendin tonë, dhe poashtu gëzon nderim të veçantë në folklorin dhe mitologjinë shqiptare si kafshë përplot madhësi dhe krenari.

Kaprolli njihet si kafshë e egër që jeton në disa vende të botës e poashtu edhe në trevat shqiptare.





QENI I SHARRIT – DELTARI ILIR

KATEGORIA: Faunë

Qeni i Sharrit apo ndryshe Deltari Ilir është qen autokton në trojet tona. Sipas të dhënave historike ky qen njihet që nga Iliria me emrin Qeni Dardan.

Ky lloj i qenit njihet për karakterin e shoqërueshëm, por të ashpër. Ndryshe nga racat e tjera, që janë besnik ndaj pronarit dhe familjes së tij, qeni i Sharrit është i lidhur vetëm me pronarin gjatë gjithë jetës së tij.

Për nga konstrukti duket qen me plot fuqi, qimegjatë, deltar i pazëvendësueshëm dhe rojtar i mirë. Karakteristika tjera fizike të tij janë: i fuqishëm, me pamje të vendosur, me kokë të madhe e ndërtim të thukët, me këmbë të fuqishme dhe muskulore.





QETHJA E DELEVE

KATEGORIA: Faunë

Qethja e deleve është traditë e fermerëve në trojet shqiptare, kjo procedurë e punës ndodh njëherë në vit, dhe si traditë varësishtë nga vendi përcillet me festë simbolike.







DHEL PRA

KATEGORIA: Faunë

Enigmatike dhe dinake, dhelpra është kafshë gjithë grabitqare me trup shumë të shkathët, me turi të mprehtë, me bisht të gjatë dhe mjaft e guximshme. Kryesisht gjuan gjahun nën errësirën e natës, kurse ditën e kalon e strukur në vende të dendura ose në strofull.

Dhelprat i rrisin fëmijët e tyre në nëntokë duke i ledhatuar me dushk dhe me qimet tyre. Jetesën e tyre e bëjnë në tunele që i krijojnë për vite me radhë në formë të rrjetave. Njihen për besnike ndaj vendbanimit të tyre, jetesën e bëjnë të vetmuara ose në çift të përjetshëm.





NËPËRKA HELMUESE – VIPERA AMMODYTES

KATEGORIA: Faunë

Nëpërka helmuese, është specie e dhe gurrë duke kërkuar hardhuca. Sipas përhapur kryesisht në Gadishullin Ballkanik. Ky gjarpër është tipik për lëndina të thata shkëmbore që jeton nëpër shkurre apo përgjatë çarjeve në shkëmbinjë

dhe gurrë duke kërkuar hardhuca. Sipas studimeve që janë bërë për këtë specie, nëpërka është gjarpër ditor dhe është gjarpri më i rrezikshëm nga cilido gjarpër tjetër helmues evropian.





UJKU

KATEGORIA: Faunë

Ujku është kafshë e njohur në viset e Evropës, Azisë dhe Amerikës Veriore. Ujku jetën e tij e gjallëron përbrenda familjes apo ndonjë grupi të llojit të vetë të përbërë nga 10 deri 15 anëtarë. Si të tillë janë të njohur për jetën në tufë, madje edhe gjuetinë e kryejnë së bashku. Gjatë gjuetisë është i durueshëm dhe gjuan edhe tufa të kafshëve shtëpiake. Ujqit gjatë dimrit tërhiqen edhe në vende larg trojeve të zakonshme të tyre. Sa i përket shqisave, shqisat e të dëgjuarit dhe të nuhaturit i kanë shumë më të zhvilluara se shqisën e të pamurit.





KREDHARAKU

KATEGORIA: Faunë



Me një qafë të shkurtër dhe trup buçkan, i njohur edhe me emrin zhytra e vogël. Kredharaku është i zakonshëm pothuajse në të gjitha liqenet me ujë të ëmbël dhe rezervuarët e mesëm dhe mëdhenj por haset edhe në mjedise me ujë të njelmët. Është një banor i trojeve tona dhe mund të haset shpesh gjatë periudhës së dimrit.

Gjatë ndërtimit të folesë punon me mjaft mençuri duke ndërtuar folenë në cektinat e mjediseve ujore, të fshehur në bimësi. Por sipas të dhënave, thuhet se ky lloj kërcënohet nga tharja e mjediseve ujore dhe shkatërrimi i bimësisë ujore të cektinave ku ndërton folenë.

Fotografët

PJESËMARRËS

Falenderojmë të gjithë fotografët që morën pjesë në realizimin e librit "Në Tokën Amë, Kosovë", e që me artin e tyre bashkëpunuan në krijimin e një libri plot vlerë.

Falenderojmë: Bleron Llugiqi, Arian Mavriqi, Bleron Çaka, Meriton Dajakaj, Shkëlzen Rexha, Granit Hyseni,

Ruzhdi Pacolli, Shpëtim Kaliqani, Korr e Ha n'katun, Albert Sinani, që u bënë pjesë e këtij projekti i cili u realizua plot përkushtim, me mbi 450 foto nga lokacione të ndryshme të Kosovës, të gjitha të shkrepura në intervale të ndryshme kohore, duke shpalosur bukuritë dhe vlerat e vendit.



Banka Ekonomike
Prishtinë, Dhjetor 2022



